



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**ANGJESIA KOMBETARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR**  
**DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË**  
**ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË**  
**GJIMNAZI “PETRO NINI LUARASI” TIRANË**

Adresa: Rr. “Sami Frashëri,” e-mail: [petroninitirane@gmail.com](mailto:petroninitirane@gmail.com)

Tel: 042 22 44 47

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë më: 20. 05. 2025.

## **PLANI AFATMESËM I SHKOLLËS**

**Drejtore ZVAPT**

**Kryetar i Bordit**

**Drejtoresha e shkollës**

**Ermira MILORI**

**Sajmir MEHJA**

**Elsa SHEQI**

# Përmbajtja

HYRJE.....	4
I. QËLLIMI I PLANIT AFATMESËM PËR ZHVILLIMIN E SHKOLLËS .....	4
I.1. Baza ligjore e planit afatmesëm.....	4
I.2. Parimet e hartimit të planit afatmesëm të shkollës .....	5
I.2.1. Instrumenti 1: Vendimi për hartimin e PASH-it .....	5
II. STRUKTURA E PLANIT AFATMESËM TË SHKOLLËS .....	6
II.1. Kredoja e shkollës .....	6
II.1.1. Misioni i shkollës .....	6
II.1.2. Besimi i shkollës .....	7
II.1.2. Vizioni i shkollës .....	10
II.2. Analiza e gjendjes (Shtator 2024) .....	11
II.2.1. Lehtësitë që ofron shkolla për të nxënit .....	11
II.2.2. Bashkëpunimet e shkollës me organizma të tjerë .....	13
II.2.3. Të dhëna sociale dhe ekonomike për komunitetin dhe familjet e nxënësve .....	13
II.2.4. Të dhëna financiare për shkollën për vitin 2023 - 2024 .....	16
II.2.5. Pikat e dobëta dhe të forta të shkollës .....	16
III. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E SHKOLLËS.....	30
III.1. Prioritetet.....	30
III.2. Objektivat.....	31
IV. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE SIPAS OBJEKTIVAVE .....	33
IV.1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies .....	33
IV.2. Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve.....	35
IV.3. Digjitalizimi i procesit mësimor .....	38
IV.4. Zhvillimi profesional i mësuesve.....	40
V. MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE .....	42
VI. BUXHETI I PARASHIKUAR .....	43
VI.1 Buxheti i shkollës në kuadrin e Planit Afatmesëm 2025–2029 .....	43
VI.2 Tabela e Planifikimit Buxhetor për Zhvillimin e PASH-it 2025–2029 .....	44
VII. PROCEDURAT E HARTIMIT TE PLANIT AFATMESËM.....	46
VII.1. Formimi i ekipit hartues të planit .....	46
VII.1.1. Ekipi hartues i planit .....	46

VII.1.2. Grupi qëndror i punës për hartimin e PASH-it 2025 - 2029 .....	48
VII.1.3. Grupi i punës për hartimin e vizionit dhe përparësive .....	48
VII.1.4. Ekipi i analizës së gjendjes së nevojave të shkollës .....	48
VII.1.5. Ekipi i analizës së gjendjes së nevojave të nxënësve .....	49
VII.1.6. Ekipi i analizës së pikave të forta dhe të dobëta të shkollës .....	49
VII.1.7. Ekipi i analizës dhe përpilimit të prioriteteve .....	49
VII.1.8. Ekipi i buxhetit .....	50
VII.1.9. Grupi i trajnimit .....	50

## HYRJE

### I. QËLLIMI I PLANIT AFATMESËM PËR ZHVILLIMIN E SHKOLLËS

Në dekadën e fundit, koncepti i planifikimit në arsim ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vendet e zhvilluara perëndimore, rrjedhimisht edhe në vendin tonë, ku fokusi kryesor është vendosur tek pjesëmarrja e gjerë e grupeve të interesit dhe aktorëve të lidhur me arsimin. Kjo qasje përbën një tregues domethënës të decentralizimit, ku institucionet arsimore, në bashkëpunim dhe në bashkërendim me shkollat, e marrin vetë përgjegjësinë për planifikimin dhe zhvillimin e tyre. Një dëshmi konkrete e këtij procesi është plani afatmesëm i shkollës, që sjell përmirësime të dukshme dhe kontribuon ndjeshëm në ecurinë progresive të institucionit arsimor, sidomos kur ky plan hartohet dhe zbatohet me përkushtim nga drejtuesit e shkollës.

#### I.1. Baza ligjore e planit afatmesëm

1.	Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë.”
2	Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026.
3	Rregullore për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë dt. 28. 01. 2020.
4	Udhëzimet dhe urdhërat e ndryshme të MAS-it.
5	Kurrikulat lëndore sipas cikleve dhe viteve të shkollimit.
6.	Udhëzimet e AKP, DRAP, dhe ZVAP.
7.	Instrumente të standardizuara matjeje, si teste për arritjet e nxënësve apo instrumente të tjera për vëzhgimin e mësimdhënies dhe të nxënët, apo pyetësorë për prindër, mësues, nxënës, drejtues shkolle, etj.
8.	Bashkëpunime të vijueshme jo vetëm me qeverisjen lokale arsimore dhe MAS-in, por, në mënyrë të veçantë, me ASCAP-in, QSHA-në, universitete, shkolla të afirmuara në punën me plane afatmesme zhvillimi, me organizata jofitimprurëse që punojnë në fushën e edukimit, me grupime ose individë të shquar në fushën e arsimit, që punojnë me materiale profesionale të miratuara dhe të akredituara nga MAS-i.

## I.2. Parimet e hartimit të planit afatmesëm të shkollës

Për zhvillimin e qëndrueshëm dhe arsimin cilësor, Gjimnazi “Petro Nini Luarasi” planifikon veprimtaritë e tij nëpërmjet planit afatmesëm, një dokument që përfaqëson qasjen strategjike shumëvjeçare të gjithë aktorëve të përfshirë në hartimin e planit. Ky planifikim është i nevojshëm që të mbështetet në parime të qarta orientuese që e bëjnë procesin më efektiv dhe të realizueshëm. Drejtuesit dhe stafi mësimor janë plotësisht të ndërgjegjësuar për rëndësinë e këtij planifikimi, prandaj do të angazhohen aktivisht në zbatimin e tij.

Së pari, hartimi i këtij plani afatmesëm përfshin pjesëmarrjen e gjerë të aktorëve brenda dhe jashtë shkollës, duke nxitur bashkëpunimin dhe ndarjen e vizionit të përbashkët për të ardhmen e institucionit.

Së dyti, plani do të jetë funksional dhe i zbatueshëm në praktikën e përditshme të institucionit. Ky zbatim do të arrihet sepse plani është ndërtuar mbi parime të qëndrueshme bashkëkohore, si rezultat i një procesi reflektues, intelektual dhe krijues, që ka shqyrtuar me hollësi realitetin, nevojat dhe potencialet e shkollës.

### I.2.1. Instrumenti 1: Vendimi për hartimin e PASH-it

#### **Neni 1**

Këshilli i Mësuesve të shkollës, bazuar dhe në miratimin e Bordit të shkollës, më datë 27.08.2024, në takimin e tij të radhës, mori vendimin për hartimin e planit afatmesëm të shkollës (PASH) për periudhën 2025-2029.

#### **Neni 2**

Për përgatitjen, zbatimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit do të përkujdeset ekipi me këtë përbërje:

- |                   |                    |
|-------------------|--------------------|
| 1. Elsa SHEQI     | Drejtues e ekipit  |
| 2. Manjola DAULLE | Sekretare e ekipit |
| 3. Etleva DOKA    | Anëtare            |
| 4. Mirela KATUNDI | Anëtar             |
| 5. Vera PRENDI    | Anëtare            |

#### **Neni 3**

Ekipi për hartimin e PASH-it do t'i nënshtrohet një trajnimit triditor dhe shpenzimet e trajnimit do të mbulohen nga buxheti i shkollës.

#### **Neni 4**

Drejtuesi i ekipit ka për detyrë që deri më datë 15. 11. 2024 të hartojë një plan pune për përpilimin e PASH-it.

### **Neni 5**

Ekipi i PASH-it deri më datë 22. 11. 2024 ka për detyrë që të formojë grupet e rishikimit të punës së deritanishme në shkollë, duke u bazuar në objektivat e mëparmë.

### **Neni 6**

Drafti i parë i PASH-it duhet të përfundojë brenda datës 20. 04. 2025.

### **Neni 7**

Ekipi i PASH-it ka për detyrë që të organizojë debate, diskutime, tryeza të rrumbullakëta, të bëjë intervista, të shpërndajë pyetësorë apo instrumente të ndryshme që lidhen me synimet, me objektivat, me planin e veprimit të shkollës, me probleme të procesit të të nxënës dhe mësimdhënies, me personelin e shkollës, me nxënës (Qeverinë e Nxënësve), me prindër, me pjesëtarë të qeverisjes lokale, si dhe të qeverisjes lokale arsimore.

### **Neni 8**

Bordi i Shkollës dhe Këshilli i Mësuesve, pas shqyrtimit të PASH-it, do ta miratojë atë jo më vonë se data 15. 05. 2025. Pas miratimit të PASH-it, ekipi i punës do të krijojë menjëherë grupet dhe nëngrupet përkatëse për zhvillimin e planit të veprimtarive sipas objektivave, jo më vonë se data 20. 05. 2025.

## **II. STRUKTURA E PLANIT AFATMESËM TË SHKOLLËS**

### **II.1. Kredoja e shkollës**

Në shkollën tonë, ne besojmë në fuqinë transformuese të arsimit dhe të dijes, në vlerat e integritetit, përkushtimit dhe respektit ndaj tjetrit. Me emrin e rilindasit Petro Nini Luarasi si frymëzim, ne synojmë të edukojmë breza qytetarësh të ndërgjegjshëm, të ndershëm, kritikë dhe të aftë për të ndikuar pozitivisht në shoqëri. Ne jemi të përkushtuar ndaj një arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt së ardhmes, ku çdo nxënës ka hapësirë për të zbuluar potencialin e tij dhe për të ndërtuar rrugën drejt suksesit. Nëpërmjet arsimit, dijes, bashkëpunimit, inovacionit dhe teknologjisë, ne kultivojmë mendimin e lirë, ndershmërinë dhe atdhedashurinë. Shkolla jonë është më shumë se një institucion arsimor – ajo është një komunitet vlerash, zhvillimi dhe shprese, ku çdo ditë mbillet fara e besimit tek e ardhmja dhe e përgjegjësisë ndaj së tashmes.

#### **II.1.1. Misioni i shkollës**

Gjimnazi “Petro Nini Luarasi” ka për mision të ofrojë një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë nxënësit, duke u mbështetur në kompetencat kyçe të kurrikulës kombëtare,

zhvillimin e të menduarit kritik, inovacionit dhe kreativitetit, si dhe forcimin e vlerave demokratike, qytetare dhe kulturore të nxënësve tanë.

Shkolla jonë synon të frymëzojë të rinjtë të bëhen qytetarë aktivë, të aftë për t'u përballur me sfidat e shoqërisë moderne, përmes mësimdhënies bashkëkohore, përdorimit të teknologjisë në arsim, dhe krijimit të një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe motivues për të nxënë.

Ne besojmë në zhvillimin e potencialit të çdo nxënësi, për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për veten, komunitetin dhe mbarë vendin.

- Shkolla si Qendër Komunitare (bashkëpunimi me komunitetin dhe me prindërit.)
- Partneriteti midis mësuesve, drejtuesve, organizmave të shkollës dhe pushtetit vendor.
- Trajtimi i çdo nxënësi si unik në stilet e të nxënësve dhe në nevojat e tyre.
- Trasparenca në çdo hap të punës sonë.
- Cilësia e mësimdhënies dhe mësimnxënies, bazuar në matjet e arritjeve të nxënësve.
- Zhvillimi profesional i mësuesve.
- Mjediset e shkollës.
- Ndjekja e risive teknologjike dhe e së resë në etikë, komunikim, edukim, mësimdhënie dhe të nxënësve.
- Orientimin e nxënësve drejt prirjeve dhe tregut të punës.

### II.1.2. Besimi i shkollës

#### ➤ **Ne besojmë se nxënësit:**

- janë individë unikë, me potencial të pashtershëm për të mësuar, për të krijuar dhe për të kontribuar në shoqëri;
- janë qytetarë aktivë të së tashmes dhe të ardhmes, që duhet të frymëzohen, fuqizohen dhe mbështeten në rrugën e tyre të dijes, në përputhje me zhvillimin e kompetencave kyçe, ku përfshihen:
  - mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve,
  - komunikimi efektiv,
  - bashkëpunimi,
  - ndërgjegjësimi qytetar, mjedisor e digjital,
  - dhe ndërtimi i vetëbesimit për të ndërmarrë iniciativa.

➤ **Ne besojmë se çdo nxënës:**

- ka të drejtën të arsimohet në një mjedis të sigurt, përfshirës dhe motivues, ku respektohen dinjiteti, identiteti dhe nevojat individuale të tij, dhe ku zhvillimi i tij akademik, personal dhe social është prioritet i përhershëm i shkollës sonë.

➤ **Ne besojmë se mësimdhënia:**

- është një proces dinamik, që duhet të jetë gjithmonë në funksion të të nxënësve dhe të zhvillimit akademik të nxënësve;
- është një proces i personalizuar, që merr parasysh stilin e të nxënësve të çdo nxënësi, si edhe diversitetin e klasës ku ai mëson;
- është një veprimtari aktive dhe bashkëpunuese, ku nxënësit janë të angazhuar, kritikë dhe të motivuar për të eksploruar në fushat e dijeve;
- mbështetet tek teknologjia si një mjet mbështetës për krijimtarinë, të menduarit kritik dhe zhvillimin e kompetencave digjitale;
- vlerëson mësuesin si udhërrëfyes dhe mentor, që mbështet nxënësit në ndërtimin e autonomisë së të nxënësve, ndërgjegjësimit qytetar;
- promovon qasjen ndërdisiplinore dhe të bazuar në projekte, për të ndërlidhur njohuritë me jetën reale dhe për të ndërtuar aftësi të qëndrueshme dhe të vlefshme për tregun.

➤ **Ne besojmë se prindërit:**

- janë partnerë të pazëvendësueshëm në procesin edukues dhe arsimor të fëmijës;
- janë ura kryesore e bashkëpunimit me shkollën, si edhe një nga shtyllat më të rëndësishme për zhvillimin akademik, emocional dhe shoqëror të nxënësve;
- janë aleatët më të ngushtë të shkollës, në ndërtimin e qëndrimeve pozitive ndaj të nxënësve dhe përgjegjësisë shoqërore;
- janë partnerët kryesorë për një komunikim të rregullt, të hapur dhe të ndershëm që është thelbësor për identifikimin dhe parandalimin në kohë të çdo vështirësie të nxënësve;
- janë kultivuesit thelbësorë të vlerave si përkushtimi, ndershmëria, respekti dhe vetëbesimi;
- janë bashkëkrijuesit e një mjedisi të sigurt dhe mbështetës, ku nxënësit ndihen të vlerësuar dhe të motivuar;
- janë aktorë aktive në jetën shkollore, sidomos nëpërmjet Këshillit të Prindërve, takimeve, aktiviteteve dhe bashkëpunimeve, por edhe një burim force dhe frymëzimi për gjithë komunitetin shkollos.

➤ **Ne besojmë se mësuesit:**

- janë udhëheqësit e dijes, frymëzuesit e përditshëm të nxënësve dhe bashkëpunëtorët më të rëndësishëm për ndërtimin e një komuniteti arsimor cilësor;
- janë promovuesit e vlerave qytetare dhe kulturore, si dhe modelet profesionale për nxënësit;
- kanë misionin të ndihmojnë nxënësit të zbulojnë, zhvillojnë dhe realizojnë potencialin e tyre;
- janë krijuesit e një klime të sigurt, bashkëpunuese dhe frymëzuese për nxënësit;
- janë edhe transmetuesit e dijes, edhe mentor, edhe udhërrëfyes, edhe mbështetës emocional për çdo nxënës;
- janë aktorë të pazëvendësueshëm në formimin akademik, etik dhe social të nxënësve, prandaj shkolla i jep rëndësi të veçantë mbështetjes dhe zhvillimit profesional por edhe fuqizimit të figurës së mësuesit;
- janë bashkëpunuesit kryesorë me drejtuesit dhe me prindërit për të krijuar themelin e një shkolle moderne, gjithëpërfshirëse dhe të suksesshme.

➤ **Ne besojmë se të nxënësit:**

- është qëllimi themelor dhe boshti qendror që përshkon çdo aspekt të jetës shkollore;
- është natyrisht një proces akademik, por edhe një përvojë e gjithanshme zhvillimi, që i kapërcen muret e klasës dhe të shkollës, duke përfshirë rritjen personale, shoqërore dhe qytetare të çdo nxënësi;
- është një proces i vazhdueshëm, që nxit mendimin kritik, kuriozitetin dhe krijimtarinë tek nxënësi;
- është një proces akademik që lulëzon në një mjedis gjithëpërfshirës dhe mbështetës që respekton diversitetin;
- është proces akademik edhe më i suksesshëm kur është aktiv, bashkëpunues dhe i lidhur me situata reale të jetës;
- është një veprimtari edhe më e suksesshme kur realizohet në një kulturë ku gabimi shihet si mundësi për të mësuar dhe për të përmirësuar vetveten;
- është një përgjegjësi e përbashkët, që ndodh në bashkëpunim të ngushtë midis nxënësit, mësuesit, familjes dhe komunitetit;

➤ **Ne besojmë se shkolla jonë:**

- është modeli i një mjedisi bashkëkohorë, por gjithashtu edhe një hapësirë që edukon, frymëzon dhe fuqizon nxënësit;
- është një mjedis dinamik dhe e hapur ndaj ndryshimeve, përqafuese e teknologjisë dhe e kërkesave të një shoqërie në zhvillim të vazhdueshëm;

- vë në qendër nxënësin, duke ofruar një mësim të personalizuar që respekton nevojat, talentet dhe stilin e tij të të nxënësit;
- zhvillon kompetencat kyçe të shekullit XXI, si bashkëpunimi, mendimi kritik, komunikimi efektiv dhe përdorimi i teknologjisë;
- promovon të nxënësit gjatë gjithë jetës, duke nxitur një kulturë kurioziteti, kërkimi dhe vetëvlerësimi;
- ndërton ura bashkëpunimi midis shkollës, familjes dhe komunitetit, si partnerë të pandarë në procesin edukues;
- ofron një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe etik, ku çdokush ndjehet i vlerësuar, i dëgjuar dhe i motivuar;
- mbështet zhvillimin profesional të mësuesve, si garanci për cilësinë e mësimdhënies dhe për të nxënësit efektiv.

### II.1.2. Vizioni i shkollës

Gjimnazi “Petro Nini Luarasi” synon të jetë një qendër e shkëlqyer arsimore, që përfaqëson një komunitet bashkëkohor mësimor dhe zhvillimor, ku çdo nxënës ndihmohet të arrijë potencialin e tij të plotë akademik, personal dhe shoqëror. Shkolla jonë vendos në qendër të veprimtarisë së saj arsimore nxënësin, duke promovuar barazinë në arsim, gjithëpërfshirjen dhe cilësinë.

Mësuesit tanë janë frymëzues, udhëheqës të ndryshimit dhe bashkëkrijues të një mjedisi mësimor të hapur, gjithëpërfshirës, digjital dhe inovativ. Ata janë të përkushtuar për të ndërtuar një kulturë mësimore ku të nxënësit aktiv, mendimi kritik, kreativiteti dhe bashkëpunimi zhvillohen çdo ditë. Praktikrat pedagogjike janë të përditësuara me metodat më efektive të mësimdhënies, duke u mbështetur në teknologjinë digjitale dhe në të nxënësit gjatë gjithë jetës.

Nxënësit e shkollës sonë janë qytetarë të përgjegjshëm dhe të ndërgjegjshëm për sfidat e kohës. Ata nxiten të ndjekin pasionet e tyre, të zhvillojnë aftësitë për zgjidhjen e problemeve, për komunikimin ndërkulturor dhe për ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme. Përmes projekteve, konkurseve, klubeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, shkolla kultivon tek ta vetëvlerësimin, vetëbesimin dhe ndjeshmërinë shoqërore.

Shkolla jonë siguron kushte të përshtatshme dhe mbështetje të personalizuar për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në përputhje me angazhimin për gjithëpërfshirje. Për secilin prej tyre, krijohet një mjedis i sigurt dhe motivues që mundëson përparim dhe integrim të plotë.

Prindërit janë partnerë të pazëvendësueshëm në këtë proces. Ne besojmë në një bashkëpunim të fortë dhe të hapur me ta, në mënyrë që të sigurojmë që zhvillimi i nxënësit të jetë i qëndrueshëm dhe në përputhje me vlerat familjare dhe shoqërore. Shkolla është gjithmonë e gatshme të mirëpresë mendimet dhe pjesëmarrjen aktive të tyre në jetën shkollore.

Përballë një bote që ndryshon me ritme të shpejta, gjimnazi “Petro Nini Luarasi” synon të jetë jo vetëm një institucion mësimor, por edhe një laborator inovacioni dhe progresi, ku ide të reja marrin jetë, ku shkenca dhe teknologjia bashkëjetojnë me kulturën dhe artin, dhe ku çdo anëtar i

## **II.2. Analiza e gjendjes (Shtator 2024)**

### **II.2.1. Lehtësitë që ofron shkolla për të nxënë**

#### **II.2.1.1 Informacion infrastrukturor për ndërtesën e shkollës**

Shkolla e Mesme “Petro Nini Luarasi” mban emrin e njërit prej figurave më të shquara të Rilindjes Kombëtare, publicistit, pedagogut, Mësuesit të Popullit dhe atdhetarit të devotshëm, Petro Nini Luarasi. Kjo shkollë ndodhet në juglindje të qytetit të Tiranës, në njesinë administrative nr. 5, në rrugën “Sami Frashëri” dhe ka nisur funksionimin e saj në vitin shkollor 1959. Deri më 1965, ajo ka funksionuar si shkollë e mesme 11-vjeçare, bazuar në strukturën e atëhershme të arsimit.

Në vitin 1968, u krijuan laboratorët e parë mësimorë, të cilët u pajisën me mjete didaktike moderne. Shkolla u pajis gjithashtu me ambiente sportive dhe të stërvitjes ushtarake, të cilat konsideroheshin ndër më të mirat në Shqipëri. Njëkohësisht, iu kushtua rëndësi rregullimit estetik të mjediseve të brendshme dhe të jashtme të institucionit.

Gjatë viteve 1986-1990, shkolla iu nënshtrua një rikonstruksioni të rëndësishëm, me përmirësime të dukshme në infrastrukturën e brendshme dhe të jashtme. U ndërtua një shtesë e godinës, u sistemuan terrenet përreth, u gjelbërua ambienti, ndërkohë që klasat dhe mjediset e tjera u pajisën me kushte të rehatshme dhe bashkëkohore. U pasuruan laboratorët e kimisë dhe gjuhëve të huaja; u ndërtuan dy palestra për forcë dhe aerobi; dhe u aplikua me sukses metoda të të nxënëtorit problemor, aktiv dhe krijues. Kjo periudhë shënoi gjithashtu përfshirjen për herë të parë të lëndës së informatikës me laborator të dedikuar për mësimin e kompjuterit.

Në vitin 2001, u realizua një rikonstruksion i përgjithshëm i godinës, i cili krijoi kushte më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe rikonfirmoi shkollën si një institucion me vlera të forta morale, njerëzore dhe demokratike. U përmirësua ndjeshëm mësimdhënia e gjuhëve të huaja dhe laboratorët u lidhën me rrjetin e internetit.

Gjatë viteve 2009-2010 u bë rikonstruksioni i brendshëm i shkollës, përfshirë shtrimin e pllakave, instalimin e dyerve të reja, përmirësimin e pajisjeve mësimore dhe rinovimin e tualeteve. Në vitin 2017 u sistemuan dhe rikonstruktuan fushat sportive. Aktualisht, mjediset e jashtme janë të bollshme dhe shumë funksionale, duke përfshirë edhe një fushë tenisi, e vetmja në gjimnazet e Tiranës.

Shkolla është e mirëmbajtur dhe përmbush standardet infrastrukturore, me klasa të ndriçuara dhe të ajrosura mirë, me hapësirë mesatare 1.4–1.5 m<sup>2</sup> për nxënës. Pajisjet mësimore janë funksionale dhe të ruajtura në gjendje të mirë. Sistemi hidro-sanitar dhe ai elektrik janë në kushte të mira, ndërsa ngrohja sigurohet përmes kaldajës. Tualetet dhe mjediset e tjera ndihmëse përmbushin standardet e sigurisë. Mungojnë shkallët e emergjencës, por në çdo kat janë të vendosura mjetet për mbrojtje nga zjarri.

Institucioni ka një oborr me sipërfaqe rreth 1200 m<sup>2</sup> dhe funksionojnë dy kabinete të informatikës, ku kompjuterat desktop nuk janë të lidhura me internetin. Shkolla ka edhe laboratorë të kimisë, biologjisë, fizikës dhe gjeografisë me pajisje relativisht të amortizuara. Shkolla ka edhe një laborator të inteligjencës artificiale me me 21 laptopë. Në shkollë ka dy linja interneti, një linjë e dedikuar për shkollën dhe një tjetër për laboratorin e (IA) inteligjencës artificiale. Shkolla ka një zyrë drejtori, një zyrë nëndrejtori, dhe 36 mjedise mësimore, dhe një palestër, një fushë tenisi, një fushë minifutbolli, një volejbolli-basketbolli.

Ndër mjediset mbështetëse përmenden dhomat për shërbimin psikosocial, mjekësor, për oficerin e sigurisë, dentisten dhe Qeverinë e Nxënësve. Mjetet didaktike si harta dhe tabela janë përgjithësisht funksionale. Shkolla ka edhe dy salla për mësuesit, një sallë për koordinatoren e këshillimit të karrierës dhe një sallë për koordinatoren e sigurimit të cilësisë.

### **II.2.1.2. Biblioteka e shkollës**

Biblioteka e gjimnazit “Petro Nini Luarasi” shtrihet në një hapësirë funksionale prej 60 m<sup>2</sup>, e pajisur me kushte të përshtatshme për lexim dhe punë individuale. Aktualisht, fondi i librave përbëhet nga 2,052 tituj, me një vlerë totale prej 1,022,954.7 lekësh. Biblioteka ofron një gamë të larmishme materialesh letrare dhe shkencore në shërbim të nxënësve dhe stafit pedagogjik. Numri i lexuesve të rregullt është 591, gjë që tregon një interes të vazhdueshëm për leximin dhe shfrytëzimin e bibliotekës si burim informacioni dhe kulture. Furnizimi i fundit me 332 libra është realizuar në vitin 2011, çka dëshmon nevojën për pasurim të mëtejshëm të fondit me tituj bashkëkohorë. Megjithatë, gjendja fizike e mjedisit të bibliotekës është e mirë, e mirëmbajtur dhe e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive letrare dhe edukative.

Biblioteka e shkollës “Petro Nini Luarasi” është gjithashtu një burim i vlefshëm për zhvillimin profesional të mësuesve dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Një pjesë e mirë e stafit pedagogjik është e anëtarësuar dhe përfiton nga fondi i pasur me libra shkollorë, metodika, manuale pedagogjike dhe revista shkencore, ku më i kërkuari është katalogu i Metodologjisë. Rreth 30% e mësuesve përdorin rregullisht materiale të specializuara për lëndët që japin. Veçanërisht i vlerësuar është edhe libri artistik, ndërsa mësuesit shpesh kontribuojnë në pasurimin e bibliotekës

përmes dhurimeve. Kjo hapësirë nuk shërben vetëm për ruajtje librash, por është një mjedis aktiv që mbështet dijen, frymëzimin dhe një mësimdhënie më cilësore.

Në përfundim, shkolla “Petro Nini Luarasi” përfaqëson një institucion me histori, përkushtim dhe vizion të qartë për të ardhmen, duke i ofruar brezave të rinj një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë dhe inovacionit në arsim.

Mund të konstatohet se mjedisi i shkollës ofron kushte të përshtatshme për lehtësimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Megjithatë, ndikimi i tij do të jetë realisht i vlefshëm nëse mjediset shfrytëzohen në mënyrë efektive nga mësuesit. Vetëm në këtë mënyrë ai kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara në planin afatmesëm të zhvillimit të shkollës për katër vitet e ardhshme.

### **II.2.2. Bashkëpunimet e shkollës me organizma të tjerë**

Gjimnazi “Petro Nini Luarasi” në Tiranë ka ndërtuar një bashkëpunim të qëndrueshëm dhe të frytshëm me institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile, çka ka ndikuar ndjeshëm në lehtësimin dhe përmirësimin e ecures së punës në shkollë.

Shkolla jonë ka ruajtur dhe vazhdon të forcojë lidhjet me një sërë institucionesh të rëndësishme, duke përfshirë institucionet e linjës, si Zyrën Vendore Arsimore Tiranë, ASCAP-in, Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, AKAP-in, Qendrën për Sigurimin e Cilësisë në Arsim (QSHA), me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor-edukativ.

Gjithashtu, bashkëpunimi shtrihet edhe me organizata joqeveritare, universitete publike dhe jopublike, Njësinë Administrative Nr. 5, Bashkinë e Tiranës si dhe me strukturat e Kryqit të Kuq Shqiptar, duke krijuar kështu ura efektive bashkëpunimi në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të shkollës dhe mirëqenies së komunitetit shkollor.

### **II.2.3. Të dhëna sociale dhe ekonomike për komunitetin dhe familjet e nxënësve**

Shkolla “Petro Nini Luarasi” ndodhet në zemër të Njesisë Administrative Nr. 5, një nga 24 njësitë që përbëjnë Bashkinë e Tiranës, e pozicionuar në pjesën jugperëndimore të kryeqytetit. Kjo njësi përfshin lagje të njohura si Blloku, Selita dhe Tirana e Re. Pas reformës territoriale të vitit 2015, Njësia Nr. 5 u konsolidua në një nga zonat më të mëdha urbane të Tiranës, me një popullsi prej rreth 87,000 banorësh.<sup>1</sup>

Komuniteti përreth shkollës përbëhet nga shtresa të ndryshme sociale dhe ekonomike, ku pjesa më e madhe e banorëve janë të punësuar në sektorin publik, si administratë shtetërore, arsim dhe

---

<sup>1</sup> Këto të dhëna janë të bazuara në informacionin e marrë nga Bashkia e Tiranës.

shëndetësi, por gjithashtu ka edhe një përqindje të konsiderueshme që i përket biznesit të vogël dhe të mesëm, si edhe një numër banorësh të papunë.

Ky komunitet është i larmishëm nga pikëpamja gjeografike dhe kulturore, pasi përfshin familje të ardhura nga të gjitha zonat e vendit – nga veriu, jugu, Shqipëria e mesme dhe ultësira lindore – të cilët janë vendosur në këtë zonë sidomos pas viteve 1990, si rezultat i migrimit të brendshëm masiv. Një pjesë e banorëve të kësaj zone nuk janë ende të legalizuar, çka e bën këtë komunitet edhe më kompleks në përbërje dhe nevoja.

Shkolla “Petro Nini Luarasi” ka një popullatë nxënësish prej 1,010 nxënësish, të cilët përfaqësojnë një numër të ngjashëm familjesh. Duke marrë parasysh një mesatare prej rreth 5-6 anëtarësh për familje, vlerësohet se mbi 6,000 banorë janë të lidhur direkt ose tërthorazi me shkollën. Rrjedhimisht, shkolla luan një rol kyç në jetën komunitare, duke ndikuar jo vetëm në zhvillimin arsimor të nxënësve, por edhe në përfshirjen dhe ndërgjegjësimin social të familjeve.

Komuniteti rreth shkollës karakterizohet nga nivele të ndryshme ekonomike, që variojnë nga niveli nën mesatar, tek mesatar e deri tek niveli mbi-mesatar, gjë që ndikon edhe në mënyrën e përfshirjes së tyre në jetën shkollore. Prania e kulturave dhe përkatësive të ndryshme brenda komunitetit ka krijuar një mjedis të larmishëm dhe të pasur ndërkulturor, çka përbën një vlerë të rëndësishëm për edukimin gjithëpërfshirës dhe bashkëkohor që synon të realizojë shkolla.

### **II.2.3.1. Të dhëna sociale dhe ekonomike për familjet e nxënësve**

Bazuar në të dhënat e hartës sociale të shkollës së mesme “Petro Nini Luarasi” për vitin shkollor 2024–2025, gjendja sociale dhe struktura e komunitetit të nxënësve paraqitet si më poshtë:

Shkolla numëron gjithsej 1030 nxënës, të shpërndarë në klasat X, XI dhe XII. Nga këta, 499 janë vajza, që përfaqësojnë 48.4% të popullsisë shkollore, ndërsa 531 janë djem, ose 51.6% e komunitetit të nxënësve.

Arsimi i prindërve, në pjesën më të madhe të rasteve, rezulton të jetë i lartë (659 raste), ndërkohë që një numër më i vogël, ose 336 prindër kanë arsim të mesëm, kurse 35 prindër kanë arsim 8-vjeçar.

Për sa i përket problematikave të tjera sociale, shkolla regjistron:

- 18 nxënës që përfitojnë ndihmë ekonomike;
- 47 nxënës që kanë humbur një nga prindërit,
- 71 nxënës me prindër të divorcuar,
- 4 nxënës që nuk janë nën kujdestarinë e prindërve,
- 1 nxënës në perkujdesje institucionale,
- 13 nxënës të kthyer nga emigracioni,
- 24 nxënës me nënshtetësi të huaj,

- 2 nxënës të rikthyer nga zona konflikti,
- 1 nxënës nga komuniteti rom.

Shkolla identifikon gjithashtu:

- 3 nxënës përsëritës,
- 1 nxënës braktisës
- 7 nxënës me tendencë braktisjeje,
- 10 nxënës me probleme sjelljeje,
- 6 nxënës që abuzojnë me substanca si duhani apo alkooli,
- 38 nxënës me rezultate shumë të dobëta në mësim.

Në anën tjetër, vlerësohet me krenari që 199 nxënës shfaqin talente në fusha si sporti, muzika, letërsia dhe piktura, duke e bërë këtë kategori një potencial të madh për zhvillimin kulturor dhe artistik të shkollës.

Përsa i përket aftësive të kufizuara, rezulton se shkolla ka vetëm një nxënës me verbëri të pjesshme, ndërsa nuk ka nxënës me çrregullime të të nxënës, as me çrregullime të tjera mendore apo fizike të dokumentuara.

Të dhënat tregojnë gjithashtu një dinamikë të lëvizshme të nxënësve, me 28 nxënës të ardhur rishtazi nga shkolla të tjera. Gjithashtu, 11 raste shëndetësore janë të dokumentuara si problematika mjekësore të evidentuara.

Kjo panoramë sociale përbën një element thelbësor në hartimin dhe zbatimin e politikave mbështetëse dhe planeve të ndërhyrjes në kuadër të PASH-it (Plani Afatmesëm i Shkollës), duke garantuar përfshirje, barazi në arsim dhe mbështetje të diferencuar sipas nevojave të nxënësve.

<b>Pika të forta</b>	<b>Pika të dobëta</b>
<p>➤ <b>Mbështetje sociale e vazhdueshme:</b> shkolla ka treguar një kujdes të veçantë për nxënësit që jetojnë vetëm me një prind, si dhe për ata që vijnë nga familje me vështirësi ekonomike, duke i përfshirë në mekanizma mbështetës dhe aktivitete sociale që synojnë aktivizimin dhe përfshirjen e tyre sociale.</p> <p>➤ <b>Fryma e humanizmit dhe vullnetarizmit:</b> vërehet një ndjeshmëri në rritje e</p>	<p>➤ <b>Numër i lartë nxënësish me prindër të divorcuar:</b> kjo situatë ndikon ndjeshëm në mirëqenien emocionale dhe motivimin për të mësuar, duke kërkuar një angazhim më të strukturuar nga shërbimi psikosocial.</p> <p>➤ <b>Vështirësi në identifikimin e problematikave sociale dhe emocionale:</b> megjithë përpjekjet e vazhdueshme të stafit psiko-social, nxënësit shpesh nuk janë të hapur për të ndarë shqetësimet që</p>

<p>komunitetit shkollor për të ndihmuar individët dhe grupet në nevojë. Kjo reflektohet përmes pjesëmarrjes aktive të nxënësve në iniciativa vullnetare dhe fushata ndërgjegjësimit të organizuara nga vetë shkolla ose shkolla në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile.</p>	<p>përjetojnë, çka pengon ofrimin në kohë të ndihmës së duhur.</p> <p>➤ <i>Qasje e kufizuar bashkëpunimi nga prindërit:</i> disa prindër refuzojnë të pranojnë ekzistencën e problemeve socio-emocionale të fëmijëve të tyre, duke mos i marrë seriozisht këshillat dhe ndërhyrjet e stafit mbështetës. Mungesa e diagnozave të specializuara dhe e bashkëpunimit me profesionistë të shëndetit mendor jashtë shkollës, vështirëson ndjeshëm trajtimin e çrregullimeve të sjelljes dhe situatave të ndërlikuara psikologjike.</p>
---	---

#### II.2.4. Të dhëna financiare për shkollën për vitin 2023 - 2024

##### Të Ardhura e mbledhura për vitin 2023 - 2024

<b>ZËRAT E TË ARDHURAVE</b>	<b>SHIFRA</b>
Të Ardhura nga kontributet e prindërve	632500
Të Ardhura nga palë të treta	89100
Gjendja nga viti i kaluar	102762
Të Ardhura nga Bashkia Tiranë (Projekti Sipërmarrja Ime)	600000
Të Ardhura nga maturantët për pelerinat dhe ceremoninë e diplomimit	273000
Të Ardhura nga palë të treta	133700
<b>TOTALI I TË ARDHURAVE</b>	<b>1.831.062</b>

#### II.2.5. Pikat e dobëta dhe të forta të shkollës

##### NXËNËSIT

##### NDJEKJA E SHKOLLËS

##### Numri i të gjithë nxënësve të shkollës në vitin shkollor 2023 – 2024

Nr.	Klasat	Numri i klasave	Nxënës gjithsej
1.	X	11	330
2.	XI	11	369
3.	XII	11	336
	<b>Totali</b>	<b>33</b>	<b>1035</b>

Numri i të gjithë nxënësve të shkollës aktualisht: viti shkollor 2024 – 2025

Nr.	Klasat	Numri i klasave	Nxënës gjithsej
1.	X	9	305
2.	XI	11	332
3.	XII	12	373
	<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>1010</b>

Shkolla ka aktualisht **1010 nxënës**, të ndarë në **32 klasa** dhe mësimi zhvillohet gjatë paradites. Numri mesatar i nxënësve për klasë është **31.5** nxënës për klasë. Raporti mësues – nxënës në fillimin e vitit shkollor (shtator 2024) ishte **1 me 16**, (pra, **1030** nxënës / **64** mësues.) Gjatë vit shkollor 2024 – 2025, në shkollë zhvillohen katër gjuhët të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht.

Numri i të gjithë nxënësve të shkollës në vitin e pritshëm shkollor: 2025 – 2026

Nr.	Klasat	Numri i klasave	Nxënës gjithsej
1.	X	9	310
2.	XI	9	305
3.	XII	10	332
	<b>Totali</b>	<b>28</b>	<b>1047</b>

Përqindja e braktisjes së shkollës në vitin shkollor 2023 – 2024 – **0%**

Përqindja e mungesave të nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore në vitin 2023 – 2024

	Nr klasave	Nr orëve në javë	Javë mësimore	Ore gjithsej	Numri nxënësve	Mungesat	Mungesat/nxënës	% e mungesave të nxënësve
Klasa 10	9	31	36	10044	262			
	2	30	36	2160	68			
	11			12204	330	19400	58.8	5.3%
Klasa 11	11	30	36	11880				
	11			11880	369	18960	51.4	4.8%
Klasa 12	9	30	34	9180	278			
	2	31	34	2108	58			

	11		11288	336	21136	62.9	6.1%
<b>Gjithsej</b>	<b>33</b>		<b>35372</b>	<b>1035</b>	<b>59496</b>	<b>57</b>	<b>5.4%</b>

## ARRITJET LËNDORE

Mesatarja e notës vjetore për **vitin shkollor 2023 – 2024** është **8.5**.

Përqindja e kalueshmërisë vjetore është **94,69%**.

Përqindja e kalueshmërisë pas provimeve të vjeshtës është **100%**

Nota mesatare në Maturën Shtetërore është **8.52**.

Nota mesatare në gjuhë shqipe dhe letërsi **8.43**.

Nota mesatare në matematikë është **8.29**

Nota mesatare në gjuhën e huaj është **8.84**

Nota mesatare në provimin me zgjedhje është **9.2**

Përqindja e kalueshmërisë në Maturën Shtetërore është **99.4%**.

Përqindja e maturanëve që janë pranuar në shkollat e larta është **95%**.

<b>Pika të forta</b>	<b>Pika për përmirësim</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i><b>Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë së arritjeve:</b></i> vërehet një rritje e qëndrueshme në rezultatet e nxënësve si në vlerësimet vjetore, ashtu edhe në Maturën Shtetërore, tregues që dëshmon për një përmirësim të metodave të mësimdhënies dhe përkushtim nga ana e stafit mësimor.</li> <li>➤ <i><b>Ulje e diferencave mes notës mesatare vjetore dhe asaj të Maturës Shtetërore:</b></i> ky tregues reflekton një përputhshmëri më të mirë midis procesit të vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, duke dëshmuar për objektivitet dhe koherencë në standardet e vlerësimit.</li> <li>➤ <i><b>Zgjerimi i përdorimit të internetit në</b></i></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i><b>Mungesë qëndrueshmërie në punën me nxënësit me arritje bazë:</b></i> puna me nxënësit që ndodhen në nivelin minimal të arritjeve shpesh nuk është e vazhdueshme dhe nuk sjell rezultate të qëndrueshme në përmirësimin e performancës së tyre.</li> <li>➤ <i><b>Mungesa e një plani individual të mirëstrukturuar për nxënësit me vështirësi në të gjitha lëndët:</b></i> vonesa në hartimin dhe zbatimin e planeve individuale ndikon negativisht në përparimin e këtyre nxënësve dhe pengon personalizimin e procesit mësimor.</li> <li>➤ <i><b>Vonesa në identifikimin dhe trajtimin e nxënësve me prirje të veçanta:</b></i> mungesa e</li> </ul>

<p><b>procesin mësimor:</b> prania e internetit në të gjitha ambientet mësimore ka lehtësuar aksesin në informacion bashkëkohor dhe ka ndihmuar në zbatimin e një metodologjie mësimore më efikase dhe më interaktive.</p>	<p>një sistemi të konsoliduar për të evidentuar talentet dhe aftësitë e veçanta e pengon zhvillimin e tyre në mënyrë të strukturuar dhe të vijueshme.</p>
--	---

### Përmbledhje e objektivave strategjike për mbështetjen e nxënësve me vështirësi

1. Identifikimi dhe ndjekja sistematike e nxënësve me vështirësi në të nxënë, përmes vlerësimeve të brendshme dhe rekomandimeve të mësuesve, psikologut dhe prindërve.
2. Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të të nxënë (PITN) për çdo nxënës që ka nevojë për mbështetje të diferencuar.
3. Përdorimi i metodave dhe strategjive të personalizuara të mësimdhënies, që përshaten me stilin dhe ritmin e të nxënë të çdo nxënësi.
4. Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit mësimor përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të praktikave të mira për gjithëpërshirjen.
5. Përshirja aktive e prindërve dhe bashkëpunimi i ngushtë me ta, për të ndjekur përparimin dhe për të përforcuar mësimin edhe jashtë mjedisit shkollor.
6. Krijimi i një mjedisi të sigurt, gjithëpërshirës dhe motivues, që e bën nxënësin të ndihet i mirëpritur dhe i pranuar.

Përdorimi i vlerësimeve të vazhdueshme për matjen e përparimit, jo vetëm në aspektin akademik, por edhe në sjellje, angazhim dhe vetëbesim.

### Tabela e monitorimit të përparimit të nxënësve me vështirësi

Fusha	Treguesi i Përparimit	Instrumenti i Matjes	Frekuenca e Vlerësimit	Përgjegjësit
Të nxënë akademik	Rritje në notat mesatare në lëndët bazë	Vlerësimet mujore dhe semestrale	Çdo muaj / çdo semestër	Mësuesit lëndorë / Koordinatori
Pjesëmarrja	Rritje e pjesëmarrjes aktive në orë mësimore	Vëzhgime nga mësuesit, fletë reflektimi	Javore	Mësues kujdestar / Psikologu

Fusha	Treguesi i Përparimit	Instrumenti i Matjes	Frekuenca e Vlerësimit	Përgjegjësit
Puna e pavarur	Realizimi i detyrave të shtëpisë dhe angazhimi në punë të pavarur	Analizë detyrash / Portofoli nxënësi	Çdo dy javë	Mësuesit e lëndëve
Aftësi sociale	Bashkëpunimi me bashkëmoshatarët, respektimi i rregullave	Vëzhgim, ditar vlerësimi psikosocial	Çdo muaj	Psikologu / Kujdestari
Vetëbesimi dhe motivimi	Shfaqje e iniciativës dhe përfshirje në aktivitete shkollore	Intervistë, vëzhgim, pjesëmarrje në klube	Çdo tremujor	Mësuesit e aktiviteteve / Psikologu
Përfshirja e prindërve	Pjesëmarrja në takime, komunikim i rregullt me shkollën	Regjistër takimesh, feedback	Çdo muaj	Drejtuesi / Kujdestari

### Renditja e shkollës në veprimtaritë lokale lëndore për vitin shkollor 2023 – 2024:

1. Ted Qamo – lënda matematikë – vendi i I
2. Ted Qamo – lënda histori – vendi i I
3. Klevis Çomani – lënda histori – vendi III

### Renditja e shkollës në veprimtaritë kombëtare lëndore 2023 - 2024

Viti shkollor 2023–2024 ka qenë i mbushur me suksese dhe përfaqësime dinjitoze nga nxënësit tanë në aktivitete, konkurse dhe projekte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Në fushën e sportit dhe aktivizmit qytetar, Elian Bilibashi u shqua me pjesëmarrjen e tij në "Fan Run", gjatë Maratonës së Tiranës, si dhe në ngjarjen sensibilizuese "Run4Autizëm". Ai gjithashtu u vlerësua me vendin e parë në Konferencën e Fakultetit të Shkencave Sociale, ku u diskutua tema "Standardet etike fuqizojnë institucionalizimin shkollor", së bashku me Viola Beqaraj dhe Fiorenca Bardhi, të cilat gjithashtu morën çmimin e parë për paraqitjet e tyre.

Në kuadër të edukimit për median, Elian Bilibashi u shpërblye me vendin e parë në aktivitetin "Java e edukimit për median", organizuar nga Instituti Shqiptar i Medias.

Tedi Qamo, Enea Toro dhe Geri Beqiri përfaqësuan shkollën në konkursin e teknologjisë "InTirana", organizuar nga Bashkia, ndërsa së bashku me Franc Lalajn dhe Marios Sherajn u

shpallën fitues në kompeticionin “Breaking the Borders Tech – BBTech”, të organizuar nga Universiteti i Biznesit.

Në fushën e oratorisë dhe debatit, Lidia Sotirllari shkëlqeu në Turneun Ndërkombëtar të debatit dhe fjalimit “Zërat e Ballkanit”, duke fituar vendin e parë në konkursin e esesë, vendin e dytë në performancën e përgjithshme dhe vendin e pestë në oratori. Në të njëjtin aktivitet, Blevis Allushi u rendit i dyti në kategorinë e fjalimit spontan.

Përfaqësimi ndërkombëtar nuk mungoi këtë vit: Anika Herri do të përfaqësojë Shqipërinë në Olimpiadën Ndërkombëtare të Gjermanishtes në korrik 2024. Patis Lole fitoi vendin e parë në konkursin “Jam libër”, organizuar nga COD dhe Bukinist.

Në simulimet diplomatike të ACMUN’24, Egi Qesja u shpall “Best Delegate”, ndërsa Ada Kocillari dhe Kaltrina Hykaj morën çmime “Honorable Mention”.

Në artin dramatik, Klevis Hysko u shpall “Aktori më i mirë protagonist” në TK-RIN ART 2024, ndërsa Alisia Kryemadhi mori çmimin “Aktorja më e mirë në rol” në Festivalin e Teatrove “Gjergj Trola”, ku shkolla jonë u vlerësua edhe me një çmim special.

Shkolla pati përfaqësime të denja edhe në fusha të tjera si ndihma e parë, ku u arrit vendi i tretë në konkursin e organizuar nga Kryqi i Kuq, dhe në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ku nxënësit tanë morën vendin e dytë në konkursin “Parandalimi i mbetjeve në Tiranë”, duke promovuar parimet 3R: Refuzo, ripërdor, riciklo.

Në fushën e sipërmarrjes, nxënësit tanë morën pjesë në projektin “Sipërmarrja ime në shkollë”, në dy faza – në tetor 2023 dhe maj 2024 – duke prezantuar ide kreative dhe të zbatueshme.

## ARRITJE TË ETIKËS DHE TË SJELLJES

### Treguesit kryesorë

Nr.	Treguesit	Të dhënat
1.	Masave disiplinore ndaj nxënësve	53 raste
2.	Ankesa të nxënësve që konsiderohen të drejta nga Komisioni i Etikës.	0
3.	Ankesa të mësuesve që konsiderohen të drejta nga Komisioni i Etikës.	28
4.		

Pika të forta	Pika për përmirësim
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b><i>Bashkërendim efektiv institucional:</i></b> vërehet një bashkëpunim i qëndrueshëm dhe funksional midis nxënësve, mësuesve, mësuesve kujdestarë, prindërve dhe oficerës së sigurisë, çka ndihmon në krijimin e një klime pozitive dhe të sigurt shkollore.</li> <li>➤ <b><i>Funksionimi i mirë i shërbimit psiko-social:</i></b> angazhimi i vazhdueshëm i stafit të shërbimit psiko-social në bashkëpunim me mësuesit dhe drejtuesit e shkollës, ka ndihmuar në identifikimin dhe trajtimin në kohë të rasteve që kërkojnë mbështetje psiko-emocionale.</li> <li>➤ <b><i>Aktivizimi i komisioneve shkollore:</i></b> Komisioni i Etikës dhe Komisioni i Disiplinës kanë funksionuar në mënyrë të rregullt, duke ndërmarrë masa edukative e parandaluese në situatat problematike.</li> <li>➤ <b><i>Prania dhe angazhimi i oficerës së sigurisë:</i></b> oficerja e sigurisë monitoron në mënyrë të vazhdueshme ambientet shkollore dhe raporton në kohë reale çdo problematikë, duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe disiplinës.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b><i>Përdorimi i duhanit nga disa nxënës në ambientet e tualeteve:</i></b> pavarësisht masave ndërgjegjësuese dhe ndaluese, ky fenomen sporadik mbetet një sfidë për strukturat monitoruese të shkollës.</li> <li>➤ <b><i>Përdorimi i celularëve gjatë orëve mësimore:</i></b> përdorimi i pajisjeve teknologjike jashtë kontekstit edukativ vërehet ende si një shqetësim që ndikon në përqendrimin dhe cilësinë e të nxënësve.</li> <li>➤ <b><i>Vonesa në ardhjen në orën e parë të mësimin:</i></b> një pjesë e nxënësve vijnë të shfaqin problematika në respektimin e orarit të hyrjes në shkollë, çka kërkon një komunikim më të fortë me familjen dhe angazhim të shtuar të mësuesve kujdestarë.</li> </ul>

## Drejtimi i shkollës

Pikat e forta	Nevojat
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Vizion i qartë dhe drejtim strategjik:</b> drejtimi i shkollës udhëhiqet nga një vizion i qartë për zhvillimin e institucionit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe të arsimit.</li> <li>➤ <b>Kulturë bashkëpunimi dhe transparence:</b> Komunikimi me stafin pedagogjik, nxënësit dhe prindërit është i hapur, i rregullt dhe i ndërtuar mbi parime të besimit dhe respektit të ndërsjellë.</li> <li>➤ <b>Mbështetje për zhvillimin profesional të mësuesve:</b> organizohen në mënyrë të vazhdueshme trajnime dhe takime pedagogjike për ngritjen e kapaciteteve të stafit mësimor.</li> <li>➤ <b>Përfshirja e nxënësve në jetën shkollë:</b> nxënësit angazhohen në klube, projekte, aktivitete kulturore dhe gara, duke nxitur talentin dhe zhvillimin e kompetencave të tyre sociale dhe drejtuese.</li> <li>➤ <b>Menaxhim efektiv i burimeve:</b> shkolla administron në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme buxhetin dhe burimet për të përmbushur objektivat arsimore dhe për të mbështetur nevojat e nxënësve.</li> <li>➤ <b>Zbatim i rregullores dhe siguri në shkollë:</b> sigurohet një mjedis i disiplinuar dhe i sigurt për të gjithë nxënësit, përmes zbatimit konsekuent të rregullores së</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Transformimi digjital i procesit mësimor:</b> nevojitet një qasje e strukturuar për integrimin e teknologjisë në mësimdhënie, përmes përdorimit të platformave digjitale, trajnimit të mësuesve dhe zgjerimit të infrastrukturës teknologjike në shkollë.</li> <li>➤ <b>Zhvillimi profesional i vazhdueshëm i stafit mësimor:</b> drejtimi i shkollës duhet të krijojë mundësi të qëndrueshme për ngritjen e kapaciteteve të mësuesve në përputhje me zhvillimet bashkëkohore pedagogjike dhe metodologjitë e reja të të nxënit.</li> <li>➤ <b>Menaxhimi me bazë të dhënash dhe vlerësimi i vazhdueshëm:</b> kërkohet ndërtimi i një kulture vendimmarrjeje të mbështetur në analiza të të dhënave për performancën e nxënësve, progresin mësimor dhe efektivitetin e ndërhyrjeve pedagogjike.</li> <li>➤ <b>Fuqizimi i kompetencave qytetare dhe ndërkulturore tek nxënësit:</b> shkolla ka nevojë të krijojë më shumë hapësira për edukimin qytetar, tolerancën, bashkëjetesën kulturore dhe zhvillimin e përgjegjshmërisë sociale tek të rinjtë.</li> <li>➤ <b>Zhvillimi i liderëve të rinj:</b> nevojitet një fokus i shtuar në identifikimin dhe mbështetjen e aftësive drejtuese tek nxënësit përmes programeve të</li> </ul>

<p>brendshme dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme.</p> <p>➤ <b>Përqendrim tek nxënësi:</b> vendimmarrja në shkollë fokusohet në interesin më të mirë të nxënësit, duke siguruar mbështetje individuale dhe zhvillim të balancuar akademik e social.</p>	<p>mentorimit, qeverisjes së nxënësve dhe angazhimit në projekte komunitare.</p> <p>➤ <b>Kujdesi për mirëqenien psikologjike dhe emocionale:</b> është e domosdoshme forcimi i shërbimeve të mbështetjes psikologjike dhe ndërtimi i një klime pozitive në shkollë, që promovon sigurinë emocionale dhe ndihmon në parandalimin e stresit dhe bullizmit.</p> <p>➤ <b>Partneritete të qëndrueshme me komunitetin:</b> drejtimi i shkollës duhet të nxisë bashkëpunimin me institucionet vendore, prindërit dhe sektorin privat për të krijuar mundësi reale për zhvillimin personal, akademik dhe profesional të nxënësve.</p>
---	---

## Mësuesit

Pikat e forta	Nevojat
<p>➤ <b>Eksperienca e lartë profesionale:</b> mesatarja e viteve të punës së mësuesve është rreth 23.4 vjet, çka tregon për një trupë pedagogjike me përvojë dhe stabilitet profesional.</p> <p>➤ <b>Kualifikim i avancuar:</b> 27 mësues kanë përfunduar master profesional ose shkencor në fushën e mësuesisë, duke garantuar përgatitje metodike bashkëkohore, kurse 3 mësues kanë përfunduar doktoraturën.</p>	<p>➤ <b>Përqindje e ulët e mësuesve me Kategorinë II:</b> vetëm 13 mësues mbajnë këtë kategori, duke sugjeruar nevojën për mbështetje më të madhe për mësuesit që ndodhen në këtë fazë të zhvillimit profesional.</p> <p>➤ <b>Numër i lartë mësuesish në prag të daljes në pension:</b> gati 10 mësues (16 % e trupës pedagogjike) janë në prag të daljes në pension. Ky tregues nënkupton se duhen</p>

<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Standard i lartë profesional:</b> 39 mësues janë të pajisur me Kategorinë I, që është niveli më i lartë i kualifikimit në arsimin parauniversitar.</li> <li>➤ <b>Trupë pedagogjike e konsoliduar:</b> Numri total i mësuesve është 65, duke përfaqësuar një kapacitet të mjaftueshëm për të mbuluar lëndët mësimore me cilësi dhe diversitet ekspertizash.</li> </ul>	<p>marrë masa për të garantuar vijueshmërinë dhe zëvendësimin e tyre.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve:</b> garantimi i një përditësimi të vazhdueshëm për mësuesve për zbatimin e mësimdhënies së bazuar në kompetenca.</li> </ul>
---	---

## Përvojat e mësimdhënies

<b>Pikat e forta</b>	<b>Nevojat</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Përfshirja e vazhdueshme në trajnimet profesionale:</b> mësuesit angazhohen rregullisht në trajnime dhe programe të zhvillimit profesional, duke ndjekur risitë në fushën e edukimit dhe përditësuar njohuritë e tyre pedagogjike.</li> <li>➤ <b>Përdorimi i literaturës bashkëkohore dhe burimeve profesionale:</b> stafi mësimor mbështet procesin e mësimdhënies në literaturë të specializuar dhe burime të përditësuara, duke rritur cilësinë e përmbajtjes dhe metodologjisë mësimore.</li> <li>➤ <b>Zhvillimi periodik i takimeve me ekipet kurrikulare:</b> takimet e strukturuar mujore me ekipet kurrikulare nxisin bashkëpunimin profesional, reflektimin pedagogjik dhe ndarjen e praktikave të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Menaxhim joefektiv i kohës gjatë ditës mësimore:</b> vërehen vështirësi nga disa mësues në menaxhimin optimal të kohës mësimore, çka ndikon në realizimin e plotë të objektivave të ditës.</li> <li>➤ <b>Mungesë koordinimi në përdorimin e mjeteve digjitale dhe teknologjike:</b> nuk ka një koordinim të strukturuar dhe të vazhdueshëm në përdorimin e burimeve teknologjike që shkolla disponon, gjë që kufizon integrimin efektiv të tyre në procesin mësimor.</li> <li>➤ <b>Bashkëpunim i kufizuar në hartimin e dokumentacionit pedagogjik:</b> mungon një praktikë e konsoliduar e bashkëpunimit ndërmjet mësuesve për ndarjen e përvojave në hartimin e planeve lëndore dhe përgatitjeve ditore.</li> </ul>

<p>mira ndërmjet mësuesve.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Informimi i vazhdueshëm përmes kanaleve zyrtare të informacionit:</b> mësuesit ndjekin dhe përdorin faqet zyrtare të shkollës dhe platformat online si Web, YouTube, etj., për t'u informuar mbi zhvillimet institucionale dhe nismat arsimore.</li> <li>➤ <b>Pjesëmarrja aktive në rrjetet profesionale të mësuesve:</b> angazhimi në rrjete profesionale të mësuesve i ndihmon ata të shkëmbejnë ide, përvoja dhe praktika të suksesshme mësimore, duke kontribuar në zhvillimin e komunitetit profesional.</li> <li>➤ <b>Shpërndarja e praktikave të mira dhe promovimi i mësimdhënies bashkëkohore:</b> projektet dhe orët më të mira të realizuara nga mësuesit promovohen në faqet zyrtare të shkollës (Web, YouTube, Facebook), si modele frymëzuese për mësimdhënie efektive dhe bashkëkohore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Nevojë për një plan zhvillimi profesional të strukturuar:</b> kërkohet përmirësimi i një plani të qëndrueshëm zhvillimi profesional, që të mbështesë mësuesit në hartimin, zhvillimin dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve sipas standardeve bashkëkohore.</li> </ul>
--	---

## Marrëdhëniet me komunitetin

Pikat e forta	Nevojat
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe Këshillin e Prindërve:</b> shkolla mban marrëdhënie të rregullta dhe të strukturuar me prindërit përmes takimeve periodike, konsultimeve dhe përfshirjes së tyre në</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b>Përfshirje e pjesshme e prindërve në jetën shkollë:</b> jo të gjithë prindërit angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitetet dhe proceset vendimmarrëse të shkollës, çka kufizon ndikimin e tyre pozitiv në jetën e përditshme shkollë.</li> </ul>

<p>vendimmarrje për çështje që prekin jetën shkollore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b><i>Përfshirja e komunitetit në veprimtari edukative dhe kulturore:</i></b> organizohen aktivitete të hapura ku komuniteti, përfshirë institucione lokale dhe organizata, ftohet të marrë pjesë, duke forcuar lidhjen e shkollës me mjedisin rrethues.</li> <li>➤ <b><i>Partneritete me institucione publike dhe joqeveritare:</i></b> shkolla bashkëpunon me institucione kulturore, arsimore dhe sociale për të pasuruar ofertën mësimore dhe për të ndihmuar në zhvillimin e kompetencave qytetare dhe sociale të nxënësve.</li> <li>➤ <b><i>Promovimi i figurës dhe arritjeve të shkollës në hapësira publike:</i></b> shkolla është aktive në komunikim me publikun përmes faqeve zyrtare dhe rrjeteve sociale, duke promovuar vlerat, arritjet dhe përfshirjen në jetën komunitare.</li> <li>➤ <b><i>Angazhimi i aktorëve të komunitetit në orientimin profesional të nxënësve:</i></b> nëpërmjet ftesës së profesionistëve të fushave të ndryshme dhe organizimit të aktiviteteve informuese, shkolla ndihmon nxënësit në orientimin e tyre akademik dhe profesional.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <b><i>Mungesë e një strategjie të strukturuar për bashkëpunimin me komunitetin:</i></b> nuk ekziston një plan i mirorganizuar dhe afatgjatë për përfshirjen e aktorëve të komunitetit lokal në jetën e shkollës.</li> <li>➤ <b><i>Niveli i ulët i bashkëpunimit me biznesin dhe sektorin privat:</i></b> mungojnë nisma konkrete që lidhen me angazhimin e aktorëve të sektorit privat për mbështetjen e orientimit profesional të nxënësve dhe përfshirjen në projekte të përbashkëta.</li> <li>➤ <b><i>Zhvillim i kufizuar i rrjeteve komunitare të mbështetjes për shkollën:</i></b> shkolla ka nevojë të zgjerojë bashkëpunimet me institucione kulturore, qendra rinore, OJF, dhe struktura vendore për të ofruar mbështetje më të gjerë sociale dhe edukative për nxënësit.</li> <li>➤ <b><i>Komunikim jo i vazhdueshëm në kanale të ndryshme informimi:</i></b> shkolla ka nevojë të përmirësojë mënyrat dhe ritmin e komunikimit me komunitetin, përfshirë përdorimin e platformave digjitale, për të rritur transparencën dhe bashkëpunimin dypalësh.</li> </ul>
---	--

## Strategji për bashkëpunimin me sektorin privat

Në funksion të misionit të shkollës për të përgatitur nxënës të formuar jo vetëm në aspektin akademik, por edhe të aftë për t'u përballur me sfidat e tregut të punës dhe të përfshirjes aktive në jetën sociale dhe ekonomike, bashkëpunimi me sektorin privat përbën një komponent të rëndësishëm të planit të zhvillimit afatmesëm të shkollës sonë.

## Qëllimi i strategjisë:

Të krijojë ura të qëndrueshme bashkëpunimi me aktorët e sektorit privat me synimin për të ofruar më shumë mundësi praktike, mentorim profesional dhe mbështetje në zhvillimin e kompetencave të nxënësve.

## Objektivat kryesore:

- Zhvillimi i partneriteteve strategjike me biznese vendore dhe kombëtare që operojnë në fusha të ndryshme (teknologji, financë, kulturë, shërbime, industri kreative).
- Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta si: trajnime, leksione të hapura nga profesionistë të ftuar, ditë karriere, ekspozita apo konkurse tematike.
- Mbështetja materiale dhe teknike nga sektori privat për zhvillimin e mjedisit shkollor (laboratorë, pajisje IT, libra, hapësira kreative).

Konsultimi me përfaqësues të sektorit privat për përmirësimin e moduleve shkollore dhe aftësive të kërkuara në treg.

## Hapat e zbatimit:

1. Identifikimi dhe profilizimi i bizneseve që mund të kenë interes të bashkëpunojnë me shkollën, sipas fushave të interesit dhe nevojave të nxënësve.
2. Ndërtimi i një platforme bashkëpunimi, përmes krijimit të një "Komisioni për Marrëdhënie me Komunitetin dhe Biznesin" në bashkëpunim me koordinatorin e keshillimit të karrierës e cila do të koordinojë takimet dhe projektet me partnerët.
3. Organizimi i një kalendari vjetor me aktivitete që përfshijnë sektorin privat: "Java e Sipërmarrjes", "Dita e Profesionistëve", "Tregu i Karrierës".
4. Monitorimi dhe vlerësimi i bashkëpunimit, përmes feedback-ut të nxënësve, mësuesve dhe vetë partnerëve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të qasjes dhe përfitimeve.

## Rezultatet e pritshme:

- Rritje e ndërgjegjësimit të nxënësve për realitetin e tregut të punës.
- Përmirësim i kompetencave praktike dhe profesionale të nxënësve.
- Nxitje e inovacionit dhe sipërmarrjes tek të rinjtë.
- Fuqizim i rolit të shkollës si institucion që bashkëpunon aktivisht me komunitetin ekonomik lokal.
- Ndërtimi i një kulture partneriteti të qëndrueshëm mes shkollës dhe sektorit privat.

## Klima dhe kultura në shkollë

Pikat e forta	Nevojat
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi:</i> mes stafit mësimdhënës dhe drejtuesve.</li> <li>➤ <i>Marrëdhënie pozitive dhe respektuese:</i> ndërmyjet nxënësve dhe mësuesve.</li> <li>➤ <i>Përfshirje e nxënësve në vendimmarrje:</i> përmes këshillit të nxënësve dhe klubeve shkollore.</li> <li>➤ <i>Praktika të mira të komunikimit me prindërit:</i> përmes takimeve periodike dhe informimit të vazhdueshëm.</li> <li>➤ <i>Aktivitete të shumta kulturore, sociale dhe edukative,</i> që nxisin pjesëmarrjen, krijimtarinë dhe solidaritetin.</li> <li>➤ <i>Përkujdesje për ambientin fizik</i> dhe atmosferën e brendshme të shkollës.</li> <li>➤ <i>Vlera të përbashkëta</i> të përcjella nga stafi si ndershmëria, përkushtimi, përgjegjësia dhe bashkëpunimi.</li> <li>➤ <i>Funksionim i shërbimeve mbështetëse</i> si psikologu, oficeri i sigurisë dhe kabineti i këshillimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ <i>Forcimi i ndjenjës së përkatësisë</i> tek të gjithë nxënësit: sidomos ata me vështirësi sociale, emocionale apo me mungesë motivimi.</li> <li>➤ <i>Zvogëlimi i rasteve të mungesës së respektit për rregullat:</i> të tilla si përdorimi i celularëve, vonesat apo sjellje joetike.</li> <li>➤ <i>Ngritja e kapaciteteve të mësuesve</i> për menaxhimin pozitiv të klasës dhe për promovimin e një klime mbështetëse në orët mësimore.</li> <li>➤ <i>Përfshirja më e madhe e komunitetit</i> dhe prindërve në jetën shkollore për të ndërtuar ura bashkëpunimi më të forta.</li> <li>➤ <i>Zhvillimi i mëtejshëm i kompetencave sociale dhe emocionale</i> të nxënësve përmes orëve të edukimit qytetar dhe aktiviteteve praktike.</li> <li>➤ <i>Përforcimi i një kulture të vlerësimit të ndërsjellë dhe motivimit,</i> si midis nxënësve, ashtu edhe stafit.</li> <li>➤ <i>Mbështetje më e madhe për nxënësit</i> me prirje të veçanta ose me nevoja të veçanta arsimore.</li> </ul>

### III. PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E SHKOLLËS

#### III.1. Prioritetet

Pas rivlerësimit të prioriteteve institucionale, u realizua klasifikimi i tyre sipas rëndësisë, dhe grupi i punës identifikoi si më të rëndësishme katër prioritetet e para, të pasqyruara si më poshtë:

- 1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies:** përmirësimi i metodave pedagogjike dhe trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve për të siguruar një arsimim cilësor.
- 2. Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve:** fokusimi në zhvillimin e aftësive si mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe komunikimi efektiv.
- 3. Digjitalizimi i procesit mësimor:** integrimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie për të përmirësuar aksesin dhe cilësinë e arsimit.
- 4. Zhvillimi profesional i mësuesve:** sigurimi i trajnimeve të vazhdueshme dhe mbështetjes për mësuesit për të përmirësuar praktikatat e tyre pedagogjike.
- 5. Përfshirja e komunitetit dhe prindërve në procesin arsimor:** nxitja e bashkëpunimit midis shkollës, prindërve dhe komunitetit për të mbështetur zhvillimin e nxënësve.
- 6. Përmirësimi i infrastrukturës shkollore:** investimi në mjediset fizike të shkollave për të krijuar një ambient të përshtatshëm për mësim.

Nr.	PRIORITETI	KOHA E ZBATIMIT			
		2025-26	2026-27	2027-28	2028-29
1.	Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies	x	x	x	x
2.	Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve	x	x	x	x
3.	Digjitalizimi i procesit mësimor	x	x	x	x
4.	Zhvillimi profesional i mësuesve	x	x	x	x

## III.2. Objektivat

PRIORITETI	OBJEKTIVAT
<p><b>1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ruhet dhe të konsolidohet niveli i lartë i kalueshmërisë dhe i notës mesatare, si në përfundim të vitit shkollor, edhe në rezultatet e Maturës Shtetërore.</li> <li>2. Të sigurohet përmirësimi i vazhdueshëm i arritjeve të nxënësve, duke vlerësuar dhe analizuar në mënyrë periodike progresin në lëndët e Maturës Shtetërore.</li> <li>3. Të hartohen dhe të zhvillohen testime të standardizuara, jo vetëm për lëndët e Maturës Shtetërore, por edhe për lëndët e tjera, me qëllim vlerësimin objektiv të arritjeve të nxënësve.</li> <li>4. Të intensifikohet bashkëpunimi me prindërit e nxënësve, përmes informimit të rregullt mbi programet mësimore, procedurat dhe rëndësinë e cilësisë së mësimdhënies.</li> <li>5. Të organizohen testime të përsëritura standardizuese, si instrumente të vazhdueshme për matjen e nivelit të njohurive dhe për orientimin e ndërhyrjeve pedagogjike.</li> <li>6. Të forcohet partneriteti me prindërit, përmes mekanizmave të rregullt të informimit mbi ecurinë mujore të nxënësve dhe nxitjes së angazhimit të tyre në procesin edukativo-arsimor.</li> </ol>
<p><b>2. Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të nxiten aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve përmes metodave aktive të të nxënësve.</li> <li>2. Të përmirësohet kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare dhe gjuhët e huaja nëpërmjet detyrave funksionale dhe situatave reale të komunikimit.</li> </ol>

	<p><b>3.</b> Të rritet përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) nga nxënësit si mjet për të mësuar dhe për të prodhuar përmbajtje.</p> <p><b>4.</b> Të nxitet puna në grup dhe bashkëpunimi mes nxënësve si pjesë e zhvillimit të kompetencës qytetare dhe sociale.</p> <p><b>5.</b> Të forcohet vetëvlerësimi dhe përgjegjësia individuale e nxënësve për të nxitur autonominë në të nxënë.</p> <p><b>6.</b> Të promovohen projekte dhe veprimtari ndërkurrikulare që lidhin njohuritë me jetën reale dhe zhvillojnë kompetencat ndërdisiplinore.</p>
<p><b>3. Digjitalizimi i procesit mësimor</b></p>	<p><b>1.</b> Të rritet përdorimi i platformave digjitale për komunikimin dhe ndarjen e materialeve mësimore midis mësuesve dhe nxënësve.</p> <p><b>2.</b> Të aftësohen mësuesit për përdorimin efektiv të mjeteve dhe aplikacioneve teknologjike në përgatitjen dhe zhvillimin e orëve mësimore.</p> <p><b>3.</b> Të integrohen mjetet digjitale në procesin e vlerësimit formues dhe përmbledhës, duke nxitur vlerësimin në kohë reale.</p> <p><b>4.</b> Të sigurohet akses i vazhdueshëm për nxënësit në pajisje teknologjike dhe internet, për të mundësuar pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor digjital.</p> <p><b>5.</b> Të zhvillohen aktivitete ndërdisiplinore që nxisin krijimtarinë dhe inovacionin përmes përdorimit të teknologjisë.</p> <p><b>6.</b> Të krijohen dhe të përmirësohen databaza dhe arkiva elektronike për dokumentacionin mësimor dhe materialet mbështetëse.</p>
<p><b>4. Zhvillimi profesional i mësuesve</b></p>	<p><b>1.</b> Të hartohet dhe zbatohet një plan vjetor zhvillimi profesional për të gjithë stafin mësimor, në përputhje me nevojat individuale dhe institucionale.</p>

	<p>2. Të nxitet pjesëmarrja e mësuesve në trajnimet e akredituara nga ASCAP dhe në programe të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.</p> <p>3. Të forcohet bashkëpunimi profesional përmes rrjeteve të mësuesve, ekipeve kurrikulare dhe komuniteteve të praktikës.</p> <p>4. Të organizohen orë të hapura dhe sesione model për shkëmbimin e praktikave të suksesshme mes mësuesve brenda institucionit.</p> <p>5. Të zhvillohet më tej aftësia e mësuesve për të përdorur teknologjinë në procesin mësimor, në funksion të të nxënësve bashkëkohor dhe vlerësimit gjithëpërfshirës.</p> <p>6. Të inkurajohet vetëreflektimi profesional dhe përmirësimi i vazhdueshëm përmes mjeteve të vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga drejtuesit e institucionit.</p>

## IV. PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE SIPAS OBJEKTIVAVE

### IV.1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies

Prioriteti 1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies									
Nr.	Objektivat	Veprimtaritë	Koha e realizimit				Personat përgjegjës	Monitorimi	Raportimi
			I	II	III	IV			
	<b>Të ruhet dhe të konsolidohet niveli i lartë i</b>	1. Organizimi i konsultimeve të rregullta me nxënësit,	x	x	x	x	Drejtoria	Kontrolle tematike	Çdo muaj

1.	<b>kalueshmërisë dhe i notës mesatare, si në përfundim të vitit shkollor, edhe në rezultatet e Maturës Shtetërore.</b>	veçanërisht në lëndët me peshë në Maturën Shtetërore dhe ato me arritje më të ulëta. <b>2. Analiza periodike e ecurisë mësimore të nxënësve nga ekipet lëndore dhe ndarja e nxënësve sipas niveleve të arritjes, për të targetuar ndihmën pedagogjike.</b>					Koordinator i SC  Ekipet lëndore		
2.	<b>Të sigurohet përmirësimi i vazhdueshëm i arritjeve të nxënësve, duke vlerësuar dhe analizuar në mënyrë periodike progresin në lëndët e Maturës Shtetërore.</b>	<b>1. Hartimi paraprak i programeve e tematikave që do të trajtohen, në përputhje me kurrikulën dhe programet orientuese të Maturës Shtetërore.</b> <b>2. Fillimi i Konsultimeve me nxënësit në muajin janar.</b>	x	x	x	x	Drejtoria  Koordinator i SC  Ekipet lëndore	Pyetësorë  Vëzhgime	Janar - Maj
3.	<b>Të hartohen dhe të zhvillohen teste të standardizuara, jo vetëm për lëndët e Maturës Shtetërore, por edhe për lëndët e tjera, me qëllim vlerësimin objektiv të arritjeve të nxënësve.</b>	<b>1. Hartimi dhe miratimi i një kalendari të përbashkët të testeve të standardizuara, për të gjitha lëndët bazë dhe ato me zgjedhje.</b> <b>2. Përgatitja dhe përdorimi i blueprint-eve dhe rubrikave të vlerësimit për çdo test të standardizuar.</b>	x	x	x	x	Drejtoria  Koordinator i SC  Ekipet lëndore	Pyetësorë  Vëzhgime  Diskutime  Kontrolle	Gjatë gjithë vitit shkollor
4.	<b>Të intensifikohet bashkëpunimi me prindërit e nxënësve, përmes informimit të rregullt mbi programet mësimore, procedurat dhe rëndësinë e cilësisë së mësimdhënies</b>	<b>1. Shpërndarja e materialeve informuese për programet dhe rolin e prindërve në mbështetjen e të nxënësve.</b> <b>2. Mbledhja e sugjerimeve nga prindërit përmes mjeteve digjitale për të nxitur</b>	x	x	x	x	Drejtoria  Mësuesit kujdestarë  Koordinatorët	Pyetësorë  Takime  Diskutime	Gjatë gjithë vitit shkollor

		pjesëmarrjen aktive për procesin mësimor.								
5.	<b>Të organizohen testime të përsëritura standardizuese, si instrumente të vazhdueshme për matjen e nivelit të njohurive dhe për orientimin e ndërhyrjeve pedagogjike.</b>	<b>1.</b> Hartimi dhe administrimi i testeve standarde për secilën periudhë. <b>2.</b> Analiza e rezultateve dhe identifikimi i nevojave për përmirësim.	x	x	x	x	Mësuesit lëndorë  Ekipet lëndore	Testime  Të dhëna statistikore	Dhjetor  Mars  Qershor	
6.	<b>Të forcohet partneriteti me prindërit, përmes mekanizmave të rregullt të informimit mbi ecurinë mujore të nxënësve dhe nxitjes së angazhimit të tyre në procesin edukativo-arsimor.</b>	<b>1.</b> Takime mujore me këshillin e prindërve të klasave për të diskutuar ecurinë mësimore dhe sjelljen. <b>2.</b> Organizimi i “ditëve të prindërve” në shkollë, ku ata ftohen të marrin pjesë në orë të hapura ose veprimtari educative.	x	x	x	x	Drejtoria  Mësuesit kujdestarë  Koordinatori për KK.	Takime  Diskutime	Çdo muaj	

## IV.2. Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve

Prioriteti 2: Zhvillimi i kompetencave kyçe të nxënësve									
Nr.	Objektivat	Veprimtaritë	Koha e realizimit				Personat përgjegjës	Monitorimi	Raportimi
			I	II	III	IV			
1.	<b>Të nxiten aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve përmes metodave aktive të të nxënësve.</b>	<b>1.</b> Zhvillimi i orëve mësimore në formë debatesh, simulimesh dhe projekteve ndërdisiplinore, ku nxënësve kanë hapësirë për analizë dhe argumentim logjik. <b>2.</b> Organizimi i konkurseve të	x	x	x	x	Ekipet lëndore	Vëzhgime  Diskutime	Çdo muaj

		mendimit kritik dhe eseve reflektuese, ku nxënësit analizojnë çështje të ndryshme nga perspektiva të shumëanshme.							
2.	<b>Të përmirësohet kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare dhe gjuhët e huaja nëpërmjet detyrave funksionale dhe situatave reale të komunikimit.</b>	<p>1. Përdorimi i materialeve autentike (video, artikuj, podcast, lajme) për të nxitur të kuptuarin e kontekstit dhe pasurimin e fjalorit në gjuhë të huaja.</p> <p>2. Organizimi i aktiviteteve të leximit dhe interpretimit të teksteve, me fokus në analizën gjuhësore dhe stilistike, si dhe krijimin e komenteve të shkruara nga nxënësit.</p>	x	x	x	x	Ekipet lëndore	Vëzhgime Diskutime	Çdo muaj
3.	<b>Të rritet përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) nga nxënësit si mjet për të mësuar dhe për të prodhuar përmbajtje.</b>	<p>1. Zhvillimi i projekteve ndërkurrikulare me përdorim të platformave digjitale, ku nxënësit hulumtojnë, përpunojnë dhe paraqesin informacionin në formate të ndryshme (prezentime, video, infografikë etj.)</p> <p>2. Trajnime ose orë të dedikuara për përdorimin e mjeteve TIK në klasë, për përgatitjen e eseve, projekteve ose për kërkime të udhëzuara në internet.</p>	x	x	x	x	Drejtoria Ekipet lëndore	Vëzhgime Diskutime	Çdo muaj
		1. Organizimi i klubeve tematike (debati, teatri, shoqëror, mjedisor	x	x	x	x	Drejtoria	Vëzhgime	Çdo muaj

4.	<b>Të nxitet puna në grup dhe bashkëpunimi mes nxënësve si pjesë e zhvillimit të kompetencës qytetare dhe sociale.</b>	etj.), ku nxënësit punojnë së bashku për të planifikuar dhe realizuar aktivitete. <b>2.</b> Aktivitete shërbimi ndaj komunitetit apo nisma vullnetarizmi, ku nxënësit punojnë në skuadër për të ndihmuar komunitetin apo shkollën.					Mësuesit Nxënësit	Diskutime	
5.	<b>Të forcohet vetëvlerësimi dhe përgjegjësia individuale e nxënësve për të nxitur autonominë në të nxënë.</b>	<b>1.</b> Përdorimi i fletëve të vetëvlerësimit pas çdo teme apo projekti, ku nxënësi reflekton mbi përparimin dhe vështirësitë e tij. <b>2.</b> Zbatimi i metodave të të nxënësve të pavarur, si kërkime individuale, ese analitike apo miniprojekte që kërkojnë planifikim dhe vetëmenaxhim.	x	x	x	x	Drejtoria Mësuesit Nxënësit	Vëzhgime Diskutime	Çdo muaj
6.	<b>Të promovohen projekte dhe veprimtari ndërkurrikulare që lidhin njohuritë me jetën reale dhe zhvillojnë kompetencat ndërdisiplinore.</b>	<b>1.</b> Përgatitja dhe prezantimi i projekteve ndërdisiplinore nga nxënësit në formën e ekspozitave, diskutimeve apo konkurseve kreative, që shfaqin lidhjen midis njohurive dhe situatave të jetës reale. <b>2.</b> Përfshirja e komunitetit lokal apo aktorëve të jashtëm (prindër, profesionistë) në vlerësimin dhe mbështetjen e këtyre projekteve për t'i dhënë atyre dimension më praktik dhe motivues.	x	x	x	x	Drejtoria Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore

### IV.3. Digjitalizimi i procesit mësimor

Prioriteti 3: Digjitalizimi i procesit mësimor									
Nr.	Objektivat	Veprimtaritë	Koha e realizimit				Personat përgjegjës	Monitorimi	Raportimi
			I	II	III	IV			
1.	<b>Të rritet përdorimi i platformave digjitale për komunikimin dhe ndarjen e materialeve mësimore midis mësuesve dhe nxënësve.</b>	<b>1.</b> Ndërthurja e orëve mësimore tradicionale me komponentë online (blended learning) për të rritur ndërveprimin dhe qasjen ndaj materialeve në çdo kohë. <b>2.</b> Trajnime të brendshme për mësuesit mbi përdorimin efikas të platformave online.	x	x	x	x	Drejtoria  Koordinatori për SC	Vëzhgime  Takime	Çdo periudhë tre mujore
2.	<b>Të aftësohen mësuesit për përdorimin efektiv të mjeteve dhe aplikacioneve teknologjike në përgatitjen dhe zhvillimin e orëve mësimore.</b>	<b>1.</b> Krijimi i një banke burimesh digjitale në drive-in e shkollës me materiale të përgatitura nga mësuesit dhe të ndara sipas lëndëve. <b>2.</b> Zbatimi i metodave digjitale në zhvillimin e orëve mësimore, duke përfshirë video, simulime, platforma ndërvepruese dhe mjetet e vizualizimit të përmbajtjes.	x	x	x	x	Drejtoria  Koordinatori për SC	Vëzhgime  Takime	Çdo periudhë tre mujore
3.	<b>Të integrohen mjetet digjitale në procesin e vlerësimit formues dhe përmbledhës, duke nxitur</b>	<b>1.</b> Përdorimi i platformave online si Google Forms, Quizizz, Kahoot, Socrative për zhvillimin e testeve formuese dhe përmbledhëse me feedback automatik.	x	x	x	x	Drejtoria  Koordinatori për SC  Ekipet lëndore	Vëzhgime  Takime	Çdo periudhë tre mujore

	<b>vlërësimin në kohë reale.</b>	<b>2.</b> Trajnime për mësuesit mbi përdorimin e mjeteve digjitale të vlerësimit dhe analizës së të dhënave të nxënësve në kohë reale.								
<b>4.</b>	<b>Të sigurohet akses i vazhdueshëm për nxënësit në pajisje teknologjike dhe internet, për të mundësuar pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor digjital.</b>	<b>1.</b> Bashkëpunimi me institucione publike dhe private për sigurimin e pajisjeve teknologjike (laptopë, tableta) për nxënësit në nevojë. <b>2.</b> Zhvillimi i orëve informuese dhe trajnimeve për përdorimin efikas të teknologjisë nga nxënësit dhe prindërit e tyre.	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>X</b>	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore	
<b>5.</b>	<b>Të zhvillohen aktivitete ndërdisiplinore që nxisin krijimtarinë dhe inovacionin përmes përdorimit të teknologjisë.</b>	<b>1.</b> Java e Teknologjisë dhe Inovacionit – organizimi i një jave të dedikuar ku mësuesit e lëndëve të ndryshme bashkëpunojnë për realizimin e projekteve ndërdisiplinore me fokus në zgjidhje kreative për probleme reale. <b>2.</b> Projekte mediatike (podcast / video / revistë digjitale) të realizuara nga nxënësit me mbështetjen e mësuesve të gjuhës shqipe, anglishtes, teknologjisë dhe edukimit qytetar.	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>x</b>	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo muaj	
<b>6.</b>	<b>Të krijohen dhe të përmirësohen databaza dhe arkiva</b>	<b>1.</b> Krijimi i një platforme të brendshme digjitale (p.sh. Google Drive, Microsoft OneDrive) për	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>x</b>	<b>x</b>	Drejtoria Koordinatori për SC	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore	

	<b>elektronike për dokumentacionin mësimor dhe materialet mbështetëse.</b>	ruajtjen dhe shpërndarjen e materialeve mësimore nga të gjithë mësuesit. <b>2.</b> Trajnimi i stafit mësimor për përdorimin e arkivave digjitale dhe ruajtjen sistematike të të dhënave.					Ekipet lëndore		

#### IV.4. Zhvillimi profesional i mësuesve

<b>Prioriteti 4: Zhvillimi profesional i mësuesve</b>									
Nr.	Objektivat	Veprimtaritë	Koha e realizimit				Personat përgjegjës	Monitorimi	Raportimi
			I	II	III	IV			
1.	<b>Të hartohet dhe zbatohet një plan vjetor zhvillimi profesional për të gjithë stafin mësimor, në përputhje me nevojat individuale dhe institucionale.</b>	<b>1.</b> Hartimi dhe miratimi i planit vjetor të zhvillimit profesional, në fillim të vitit shkollor, bazuar në analizën e nevojave të mësuesve dhe të shkollës. <b>2.</b> Organizimi i trajnimeve dhe sesioneve të brendshme zhvillimore, në bashkëpunim me ekspertë të fushave përkatëse dhe partnerë institucionalë.	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore
2.	<b>Të nxitet pjesëmarrja e mësuesve në trajnimet e akredituara dhe në programe të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.</b>	<b>1.</b> Nxitja e aplikimeve dhe ndjekjes së kurseve me kredite përmes mbështetjes nga drejtoria dhe mentorimi nga koordinatorët. <b>2.</b> Vlerësimi i ndikimit të trajnimeve të ndjekura, përmes reflektimeve personale, takimeve të stafit dhe zbatimit në praktikë të njohurive të reja. <b>3.</b> Përfshirja e mësuesve në veprimtari të rrjeteve	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore

		profesionale, projekte kombëtare/ndërkombëtare dhe konferenca arsimore.							
3.	<b>Të forcohet bashkëpunimi profesional përmes rrjeteve të mësuesve, ekipeve kurrikulare dhe komuniteteve të praktikës.</b>	1. Organizimi periodik i mbledhjeve të ekipeve lëndore dhe kurrikulare për planifikim, reflektim dhe shkëmbim përvojash. 2. Zhvillimi i punëtorive tematike ku mësuesit bashkëkrijojnë plane mësimore dhe materiale të integruara ndërdisiplinore.	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo muaj
4.	<b>Të organizohen orë të hapura dhe sesione model për shkëmbimin e praktikave të suksesshme mes mësuesve brenda institucionit.</b>	1. Zhvillimi i orëve të hapura sipas kalendarit të trajnimeve të brendshme, me pjesëmarrje nga kolegë të të njëjtës lëndë dhe jo vetëm. 2. Organizimi i sesioneve pas orës së hapur për diskutim profesional, reflektim dhe identifikim të praktikave të suksesshme që mund të transferohen. 3. Dokumentimi i praktikave më të mira dhe krijimi i një arkive didaktike që u vihet në dispozicion gjithë stafit mësimor.	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo muaj
5.	<b>Të zhvillohet më tej aftësia e mësuesve për të përdorur teknologjinë në procesin mësimor, në funksion të të nxënit bashkëkohor dhe vlerësimit gjithëpërfshirës.</b>	1. Trajnime të brendshme për përdorimin e platformave digjitale, aplikacioneve interaktive dhe mjeteve të vlerësimit online (si Kahoot, Mentimeter, Google Forms, Socrative). 2. Integrimi i detyrueshëm i mjeteve TIK në orët mësimore, të reflektuara në planifikimet javore dhe ditore të mësuesve. 3. Demonstrimi i orëve model me përdorim efektiv të teknologjisë, duke ndarë praktikat më të mira me kolegët.	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC Ekipet lëndore	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore
		1. Përdorimi i rregullt i formularëve të vetëvlerësimit nga mësuesit në fund të çdo	x	x	x	x	Drejtoria Koordinatori për SC	Vëzhgime Takime	Çdo periudhë tre mujore

6.	<b>Të inkurajohet vetëreflektimi profesional dhe përmirësimi i vazhdueshëm përmes mjeteve të vetëvlerësimit dhe vlerësimit nga drejtuesit e institucionit.</b>	periudhe mësimore për të reflektuar mbi praktikat dhe rezultatet e arritura. <b>2.</b> Takime reflektuese individuale mes mësuesve dhe drejtuesve të shkollës për analizën e performancës dhe përcaktimin e fushave për përmirësim. <b>3.</b> Përfshirja e vetëvlerësimit në dosjen profesionale të mësuesit si pjesë e dokumentacionit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional.				Ekipet lëndore				

## V. MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE

Grupi i vëzhgimit të veprimtarive në punën e tij në vazhdimësi do të bazohet në këtë metodologji Teknika të ndryshme të vëzhgimi dhe raportimi si;

- Pyetësorë
- Takime e biseda
- Raportime tremujore
- Raportime gjatëmujore
- Raportime një vjeçare
- Raportim i përgjithshëm katër vjeçar

### PLANI AFATMESËM I ZHVILLIMIT TË SHKOLLËS

Shkolla \_\_\_\_\_

**Raport vlerësimi**

**1. Periudha që mbulon raporti: ----- (tremujore).\***

**2. Prioriteti.**

**3. Planifikimi i veprimtarive sipas objektivave.**

**4. Veprimtaritë e zhvilluara.**

**5. Ndërhyrjet dhe rezultatet e arritura.**

**6. Probleme të identifikuar gjatë zhvillimit të planit.**

**7. Rekomandime për përmirësime dhe për ecurinë e mëtejshme.**

**8. Autorët e raportit.**

**9. Bashkëlidhur shoqërohen kopje të instrumenteve të përdorura për të vjelë të dhënat e nevojshme.**

## **VI. BUXHETI I PARASHIKUAR**

### **VI.1 Buxheti i shkollës në kuadrin e Planit Afatmesëm 2025–2029**

Edhe pse shkolla përballet me kufizime në sigurimin dhe përdorimin e mjeteve financiare, ekipi i PASH-it parashikon edhe disa burime alternative për financimin e zhvillimit të shkollës. Një pjesë e rëndësishme e këtij buxheti synohet të sigurohet përmes:

- Kontributeve të prindërve,
- Mbështetjes nga organizata jofitimprurëse (OJF),
- Donatorëve individualë ose institucionalë,
- Granteve nga projekte të dedikuara për arsimin.

Buxheti i parashikuar synon të mbulojë nevojat prioritare të shkollës, si:

- Sigurimi i mjeteve didaktike bashkëkohore,
- Pajisje me libra jashtëshkollorë për pasurimin e bibliotekës,
- Mbështetje dhe motivim për nxënësit me rezultate të larta përmes projekteve educative,
- Sigurimi i materialeve të tjera të nevojshme për realizimin e objektivave strategjike të PASH-it.

Edhe pse këto burime nuk janë të garantuara në kushtet aktuale, shkolla synon të japi prioritet në ndërtimin e partneriteteve me organizata që ofrojnë shërbime në fushën e arsimit. Kjo përfshin identifikimin dhe aplikimin për grante kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat mund të përdoren për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Ky dokument përmban një planifikim të detajuar të buxhetit të parashikuar për zhvillimin e Planit Afatmesëm të Shkollës (PASH) për periudhën 2025–2029. Ai përfshin objektivat kryesore të zhvillimit institucional, aktivitetet e planifikuara, burimet e mundshme të financimit dhe shumën e parashikuar për secilin projekt. Qëllimi i këtij planifikimi është të orientojë shkollën drejt një zhvillimi të qëndrueshëm dhe bashkëkohor, në bashkëpunim me prindërit, komunitetin dhe donatorët.

## VI.2 Tabela e Planifikimit Buxhetor për Zhvillimin e PASH-it 2025–2029

Nr.	Qëllimi	Aktiviteti i planifikuar	Afati kohor	Burimi i financimit	Shuma e parashikuar (ALL)
1	Rritja e cilësisë së mësimdhënies	Blerja e mjeteve didaktike dhe teknologjisë mësimore	2025–2026	Donatorë OJF / Grante arsimore	300,000
2	Promovimi i leximit jashtëshkollor	Pajisja e bibliotekës me libra bashkëkohorë	2026	Kontributet e prindërve	150,000
3	Motivimi i nxënësve ekselentë	Çmime vjetore për arritje të larta akademike dhe projekte	Çdo vit	Fondi i shkollës / Biznese lokale	100,000/vit
4	Nxitja e mësimin me bazë projekti	Zhvillimi i projekteve ndërkurrikulare në bashkëpunim me OJF	2026–2028	Grante projektsh edukative	500,000
5	Fuqizimi i stafit mësimdhënës	Trajnime profesionale në bashkëpunim me institucione partnere	2025–2029	Grante ndërkombëtare / MAS	200,000
6	Zhvillimi i kompetencave digjitale	Krijimi i një laboratorit informatik me pajisje moderne	2027	Donatorë të huaj / Kompani teknologjike	600,000
7	Edukimi mjedisor	Organizimi i projekteve ekologjike dhe ambientale me nxënësit	2025–2029	OJQ mjedisore / Bashkia	120,000
8	Zhvillimi i sportit në shkollë	Blerja e pajisjeve sportive dhe përmirësimi i terreneve	2026–2027	Fonde publike / Biznese lokale	250,000
9	Kujdesi për shëndetin mendor	Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve për mirëqenien emocionale	2025–2029	Fondacione sociale / MAS	180,000
10	Përfshirja e komunitetit	Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe ditëve të hapura	Çdo vit	Kontribute të komunitetit / Projekte sociale	80,000 /vit

## INSTRUMENT PËR MBLEDHJEN E NEVOJAVE TË MËSUESVE

**I- Listoni elementët e procesit mësimor të paraqitura në material, për të cilat mendoni se i planifikoni dhe i zbatoni me lehtësi në klasë.**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_
9. \_\_\_\_\_
10. \_\_\_\_\_

**II- Listoni elementët e procesit mësimor që paraqiten në material, për të cilat gjykoni se keni nevojë për t'u trajnuar.**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_
9. \_\_\_\_\_
10. \_\_\_\_\_

**III-Listoni elementët e procesit mësimor që paraqiten në material, për të cilat gjykoni se nuk janë të qarta për ju.**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_
7. \_\_\_\_\_
8. \_\_\_\_\_
9. \_\_\_\_\_
10. \_\_\_\_\_

**IV- A jeni i gatshëm për t'u vëzhguar? Qarko Po Jo**

## VII. PROCEDURAT E HARTIMIT TE PLANIT AFATMESËM

### VII.1. Formimi i ekipit hartues të planit

Në hartimin e planit afatmesëm të Gjimnazit “Petro Nini Luarasi” kontribuan me mendimet e tyre të gjithë mësuesit e shkollës, anëtarë të Bordit të Shkollës, qeveria e Nxënësve, prindër të përfshirë nëpërmjet anketimeve lidhur me PASH; prioritetet, mundësitë e shkollës, pikat e forta, pikat e dobëta.

#### VII.1.1. Ekipi hartues i planit

Nr.	EMER MBIEMER	POZICIONI
1	ELSA SHEQI	Drejtor
2	MANJOLA DAULLE (TOPI)	Zv/Drejtor
3	ENTELE BURAZERI	Zv/Drejtor
4	ALMA SKILJA	Zv/Drejtor
5	ADELA LLAKAJ (LLAKATURA)	Mësuese
6	AJET TOSKA	Mësues
7	ALBANA MUCEKU (PALLUÇI)	Mësuese
8	ALMA MANCAKU (MERA)	Mësuese
9	ALMA SADIKAJ (AJAZI)	Mësuese
10	ALTIN LIKA	Mësues
11	AMALINA KAMBERI (ZHULLA)	Mësuese
12	ANILA SHAHU (PALUSHI)	Mësuese
13	ANILA SHORRI (BEQIRI)	Mësuese
14	ANILA ZELA(BRAHO)	Mësuese
15	ARBEN FESHTI	Mësues
16	ARTAN NURIU	Mësues
17	DRITA BEQAJ (HOXHA)	Mësuese
18	ELIBERTA CJAPI	Mësuese
19	ELONA BUXHELAJ	Mësuese
20	ENEIDA DURISHTI (PEMA)	Mësuese
21	ENERIDA MEMA(QËNDRO)	Mësuese
22	ENKELEJDA MANDRI (HASA)	Mësuese
23	ERIDETA IMERAJ	Mësuese
24	ERJAL SELAMAJ	Mësues
25	ERTUGEL KIKA	Mësues
26	ESMERALDA BANA (LAMÇE)	Mësuese
27	ETLEVA DOKA (BEJLERI)	Mësuese

28	ETLEVA RUÇI (PINE)	Mësuese
29	FABIOLA KAMENICA (LAMAJ)	Mësuese
30	HALIT SHEHU	Mësuese
31	ILDA PALOKA (GJOKA)	Mësuese
32	INDRIT FAGU	Mësues
33	IRENA ÇITOZI (XHAFI)	Mësuese
34	IRMA ALIKA (ÇULLI)	Mësuese
35	KREUZA BARDHI (NELI)	Mësuese
36	KRISTINA ROSHI (KRONGO)	Mësuese
37	LEA ÇINA (SKAKA)	Mësuese
38	LEDION CENGA	Mësues
39	LUDIANA BEQIRI (XHAKOLLARI)	Mësuese
40	LULJETA DEMUSHI	Mësuese
41	MATILDA BEKTASHI (CEKA)	Mësuese
42	MERITA BAKIU (BELIU)	Mësuese
43	MIRELA KATUNDI (PRIFTI)	Mësuese
44	MIRELA NOVRUZAJ (ÇYÇYRI)	Mësuese
45	MIRJETA HOXHALLARI	Mësuese
46	NERTILA META	Mësuese
47	ODETA ISLAMAJ (FERHATI)	Mësuese
48	REDONA JAÇE (PASHOLLI)	Mësuese
49	RUDINA OMARI (PAPALEKA)	Mësuese
50	SADETE STRUGA	Mësuese
51	SELAUDIN JANINA	Mësues
52	SHQIPONJA BIZHGA (CENKA)	Mësuese
53	SIDORELA NURCE	Mësuese
54	STELA KAMBERI (SHUQJA)	Mësuese
55	SUZANA QIRJO	Mësuese
56	TEUTA KAIKU (ÇELHYKA)	Mësuese
57	TRANDAFIL GUNI (KORBI)	Mësuese
58	VALBONA KARALLIU (HUNDA)	Mësuese
59	VALBONA SECI (MEMIA)	Mësuese
60	VERA PRENDI	Mësuese
61	YLLKA ÇELA (ZEKAJ)	Mësuese
		Mësuese
62	ADJONA HAMETAJ	Mësuese
63	ERMELINDA FUGA	Mësuese
64	GABRIELA SHAHOLLI	Mësuese

### VII.1.2. Grupi qëndror i punës për hartimin e PASH-it 2025 - 2029

<b>Nr.</b>	<b>EMER MBIEMER</b>	<b>POZICIONI</b>
1	Elsa SHEQI	Drejtore
2	Manjola DAULLE	N/Drejtore
3	Ledion CENGA	TIK
4	Mirela KATUNDI	Kryetare e Ekipit Shk. Sociale
5	Etleva DOKA	Kryetare e Ekipit Letërsi
6	Sajmir MEHJA	Kryetar i Këshillit të Prindërve
7	Frenki ISMAILI	Qeveria e Nxënësve

### VII.1.3. Grupi i punës për hartimin e vizionit dhe përparësive

<b>NR</b>	<b>EMER MBIEMER</b>	<b>POZICIONI</b>
<b>1</b>	<b>Elsa SHEQI</b>	<b>Drejtore</b>
2	Manjola Daulle	Nëndrejtore
3	Mirela Katundi	Mësuese
4	Etleva Doka	Mësuese
5	Enis Fita	Këshilli i prindërve

### VII.1.4. Ekipi i analizës së gjendjes së nevojave të shkollës

<b>Nr.</b>	<b>EMER MBIEMER</b>	<b>POZICIONI</b>
1	Manjola Daulle	Nëndrejtore
2	Etleva Doka	Mësuese
3	Adela Llakaj	Mësuese
4	Kristina Roshi	Mësuese
5	Vera Prendi	Mësuese

#### VII.1.5. Ekipi i analizës së gjendjes së nevojave të nxënësve

NR	EMER MBIEMER	POZICIONI
1	Entela Burazeri	Nëndrejtorë
2	Mirela Katundi	Mësuese
3	Eneida Pema	Koordinatorë e qeverisë së nxënësve
4	Indrit Fagu	Mësues
5	Frenki Ismaili	Qeveria e nxënësve

#### VII.1.6. Ekipi i analizës së pikave të forta dhe të dobëta të shkollës

NR	EMER MBIEMER	POZICIONI
1	Elsa SHEqi	Drejtorë
2	Manjola Daulle	Nëndrejtorë
3	Entela Burazeri	Nëndrejtorë
4	Kristina Roshi	Mësuese
5	Mirela Katundi	Mësuese

#### VII.1.7. Ekipi i analizës dhe përpilimit të prioriteteve

NR	EMER MBIEMER	POZICIONI
1	Manjola Daulle	Nëndrejtorë
2	Mirela Katundi	Mësuese
3	Etleva Doka	Mësuese
4	Adela Llakaj	Mësuese

<b>5</b>	Ledion Cenga	Mësues
<b>6</b>	Stela Kamberi	Mësuese
<b>7</b>	Vera Prendi	Mësuese
<b>8</b>	Kristina Roshi	Mësuese
<b>9</b>	Suzana Qirjo	Mësuese

### VII.1.8. Ekipi i buxhetit

<b>NR.</b>	<b>EMER MBIEMER</b>	<b>POZICIONI</b>
<b>1</b>	Elsa SHEQI	Drejtores
<b>2</b>	Odeta Islami	Mësuese
<b>3</b>	Sajmir Mehja	Kryetare e bordit
<b>4</b>	Enis Fita	Këshilli i prindërve
<b>5</b>	Frenki Ismaili	Qeveria e nxënësve

### VII.1.9. Grupi i trajnimit

Pasi u njoh me udhëzuesin dhe hapat e hartimit, ekipi i PASH iu nënshtrua trajnimit nga grupi i mëposhtëm trajnues.

<b>NR</b>	<b>EMER MBIEMER</b>
<b>1</b>	Manjola Daulle
<b>2</b>	Oriana Osmani
<b>3</b>	Etleva Doka
<b>4</b>	Kristina Roshi
<b>5</b>	Vera Prendi